



Projekti i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



RRJETI I KOSOVËS PËR ARSIM DHE PUNËSIM

# POLITIKAT E PUNËSIMIT DHE MIRËQENIES SOCIALE NË KOSOVË

RAPORT VLERËSIMI



# POLITIKAT E PUNËSIMIT DHE MIRËQENIES SOCIALE NË KOSOVË

RAPORT VLERËSIMI

Dhjetor 2017

Autor: Agron Demi

Design: *envinion*



Projekti i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Ky raport është hartuar me mbështetjen e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN”, që menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Projekti zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me Agjencinë për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë (APPK), Balkan Sunflowers Kosova (BSFK), Akademinë e Trajnimeve dhe Asistencës Teknike (ATTA) dhe Stichting SPARK. Përmbajtja e këtij publikimi, në asnjë mënyrë nuk mund të merret si reflektim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.

# Përmbajtja

<b>Lista e shkurtesave.....</b>	<b>6</b>
<b>Lista e tabelave.....</b>	<b>8</b>
<b>Lista e figurave .....</b>	<b>9</b>
<b>Përmbledhje ekzekutive.....</b>	<b>11</b>
<b>1. Hyrje.....</b>	<b>16</b>
<b>2. Konteksti makroekonomik.....</b>	<b>20</b>
<b>3. Agjenda qeveritare në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale .....</b>	<b>22</b>
3.1. Punësimi dhe mirëqenia sociale me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2021.....	22
3.2. Punësimi dhe Mirëqenia Sociale me Marrëveshjen për Stabilizim Asociim....	24
3.3. Punësimi dhe mirëqenia sociale me Agjendën për Reforma Evropiane .....	26
3.4. Punësimi dhe mirëqenia sociale me Programin për Reforma në Ekonomi ....	27
3.5. Punësimi dhe mirëqenia sociale me Programin qeverisës 2017-2021.....	29
3.6. Programi legjislativ i qeverisë .....	30
3.7. Struktura institucionale .....	32
<b>4. Tregu i punës .....</b>	<b>40</b>
4.1. Pjesëmarrja e grave në tregun e punës.....	43
4.2. Punësimi i të rinjve .....	46
4.3. Funksionimi i Agjencisë së Punësimit.....	49
4.3.1. Funksionimi i Qendrave të Aftësimit Profesional .....	51
4.3.2. Ndërmjetësimi në punësim .....	55
4.4. Siguria në punë.....	56
<b>5. Mirëqenia sociale .....</b>	<b>58</b>
5.1. Skemat sociale të varfërisë kundrejt Skemave sociale në bazë të kategorive ...	58
5.2. Ndihmat sociale .....	61
5.3. Pensionet e veteranëve të luftës së UÇK.....	68
5.3.1. Buxheti për pensionet e veteranëve.....	70
5.3.2. Manipulimet me lista të veteranëve dhe sfidat buxhetore.....	72
5.4. Pensionet e viktimave të torturës dhe dhunës seksuale .....	75
5.5. Shërbimet sociale.....	76
<b>6. Pensionet.....</b>	<b>80</b>
6.1. Pensionet e moshës dhe kontributdhënëse.....	83
6.2. Kursimet pensionale.....	87
<b>7. Dialogu social.....</b>	<b>90</b>
<b>8. Përfundim .....</b>	<b>94</b>

## Lista e shkurtesave

AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
IP	Inspektorati i Punës
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
ARE	Agjenda për Reforma Evropiane
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BSPK	Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës
GDP	Bruto Produkti Vendor
DFDIL	Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FRIDOM	Projekti i Rishikimit Funkcional dhe Organizimit Institucional të Ministrive
FSK	Forcat e Sigurisë së Kosovës
KES	Këshilli Ekonomik Social
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asocimit
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës

PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit
PRE	Programi i Reformave Ekonomike
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
QPS	Qendra për Punë Sociale
SIMP	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Punësimit
SMIA	Sistemin e Menaxhimit të Informatave Arsimore
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
SNS	Skema e Ndihmës Sociale
SPMS	Strategjia e Punësimit dhe Mirëqenies Sociale
TMK	Trupat Mbrojtës të Kosovës
Trusti	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

## Lista e tabelave

<b>Tabela 1:</b> Treguesit kryesorë për tregun e punës dhe kohezionin social sipas draft-Udhëzuesit të SKZH .....	23
<b>Tabela 2:</b> Veprimet e parapara në fushën e politikave sociale dhe punësimit sipas PKZMSA .....	25
<b>Tabela 3:</b> Masat në punësim sipas ARE.....	26
<b>Tabela 4:</b> Aktivitetet me PRE në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale.....	28
<b>Tabela 5:</b> Projektligjet e sponsorizura nga MPMS në programet legjislative 2013-2017.....	31
<b>Tabela 6:</b> Numri i të punësuarve në disa nga njësitë e MPMS (2009-2018).....	37
<b>Tabela 7:</b> Kurset që ofrohen nga qendrat e aftësimin profesional.....	53
<b>Tabela 8:</b> Shuma mujore e kompensimeve sipas numrit të anëtarëve të familjes 2003-2017.....	62
<b>Tabela 9:</b> Kompensimet mujore për familjet në SNS me rritjen e paralajmëruar prej 20%.....	67
<b>Tabela 10:</b> Projektionet e pensioneve të veteranëve 2018-2047 .....	73
<b>Tabela 11:</b> Veteranët përfitues në më shumë se një skemë pensionale .....	74
<b>Tabela 12:</b> Numri i pensionistëve, shkalla mujore e pensionit dhe buxheti vjetorë për pensionet e moshës.....	83

## Lista e figurave

<b>Figura 1:</b> Pjesëmarrja e MPMS në grupet ndërmnostore .....	33
<b>Figura 2:</b> Projektionet buxhetore për 2018 sipas ministrive .....	34
<b>Figura 3:</b> Buxheti i MPMS 2009-2020 .....	35
<b>Figura 4:</b> Buxheti i MPMS 2009-2020 sipas skemave.....	36
<b>Figura 5:</b> Kategorizimi i ndarjeve buxhetore sipas Ministrisë së Financave për vitin 2016.....	38
<b>Figura 6:</b> Pjesëmarrja në fuqinë punëtore, shkalla e papunësisë dhe raporti punësim/popullsi 2012-2016 .....	40
<b>Figura 7:</b> Relacioni në mes të popullsisë në moshë pune, fuqisë punëtore dhe të punësuarve 2012-2016.....	42
<b>Figura 8:</b> Punësimi i paqëndrueshëm 2012-2016.....	43
<b>Figura 9:</b> Gratë jo aktive në tregun e punës 2012-2016.....	44
<b>Figura 10:</b> Shkalla e punësimit të grave 2012-2016 .....	45
<b>Figura 11:</b> Shkalla e papunësisë tek të rinjtë 2012-2016 .....	47
<b>Figura 12:</b> Emigrantët sipas moshës.....	48
<b>Figura 13:</b> Organogrami i Agjencisë së Punësimit .....	49
<b>Figura 14:</b> Buxheti i dy divizioneve më të rëndësishme të Departamentit/Agjencisë së Punësimit (2009-2020) .....	50
<b>Figura 15:</b> Numri i përfituesve sipas llojeve të masave aktive në tregun e punës (2015-2016).....	54
<b>Figura 16:</b> Buxheti për skemat sociale si përqindje e GDP.....	60
<b>Figura 17:</b> Numri i familjeve dhe anëtarëve të tyre në SNS sipas komunave .....	63
<b>Figura 18:</b> Numri i familjeve dhe anëtarëve të tyre në SNS sipas komunave .....	64
<b>Figura 19:</b> Familjet në SNS sipas numrit të anëtarëve .....	64
<b>Figura 20:</b> Buxheti i SNS në relacion me shpenzimet totale të buxhetit të shtetit 2003-2020...	65
<b>Figura 21:</b> Mbulueshmëria e SNS kundrejt kufirit të varfërisë .....	66
<b>Figura 22:</b> Mbulueshmëria e SNS kundrejt kufirit të varfërisë pas rritjes së paralajmëruar prej 20%.....	68
<b>Figura 23:</b> Kronologjia e verifikimit të veteranëve të luftës.....	69

<b>Figura 24:</b> Buxheti për pensionet e veteranëve .....	71
<b>Figura 25:</b> Veteranët sipas grupmoshave .....	71
<b>Figura 26:</b> Pensionet e veteranëve në krahasim me GDP.....	72
<b>Figura 27:</b> Shpenzimet vjetore për kategori të ndryshme pensionale .....	81
<b>Figura 28:</b> Numri i përfituesve sipas skemave sociale.....	82
<b>Figura 29:</b> Popullsia mbi moshë 65 vjeç kundrejt përfituesve të pensioneve të moshës .....	84
<b>Figura 30:</b> Ndryshimet në moshën e popullsisë 2012-2017.....	85
<b>Figura 31:</b> Ndryshimet në moshën e popullsisë 2012-2017 .....	86
<b>Figura 32:</b> Paga minimale në vendet e rajonit* .....	91

## Përmbledhje ekzekutive

**Papunësia, veçanërisht papunësia e grave dhe të rinjve, është një ndër problemet më të mëdha të Kosovës.** Të dhënat e gjashtë mujorit të parë të vitit 2017 tregojnë se shkalla e papunësisë është 30.6%, kurse papunësia tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeç është 60.2%. Shqetësuese mbetet shkalla e lartë e inaktivitetit të grave, ku 80% e grave në moshë pune nuk janë aktive në tregun e punës. Niveli i lartë i papunësisë, njëherësh më i larti në Evropë, ndikon edhe në mirëqenien sociale. Varfëria më e madhe në Kosovë është regjistruar në mesin e të papunëve, atyre që varen nga ndihmat sociale dhe tek fëmijët.

**Nuk ekziston një strategji gjithëpërfshirëse për luftimin e varfërisë.** Përkundër asaj se punësimi dhe mirëqenia sociale zënë vend në programet e partive politike, programet qeveritare, programet legjislativë dhe marrëveshjet ndërkombëtare (MSA dhe “Stand-by” me FMN), deri më tani politikat janë zhvilluar në baza ad hoc, të ndikuara nga grupet e interesit dhe të pa harmonizuara.

**Pas pagave dhe mëditjeve, subvencionet sociale përbëjnë pjesën më të madhe të ndarjeve buxhetore.** Afërsisht 20% e buxhetit të projektuar për vitin 2018 do të menaxhohet nga MPMS, kurse në bazë të klasifikimit të ndarjeve buxhetore të cilin e publikon Ministria e Financave, çdo vit për mbrojtje sociale shpenzohet rreth 22.5% e buxhetit.

**Përkundër shpenzimeve relativisht të mëdha buxhetore, një pjesë e madhe e transfereve sociale janë skema të bazuara në kategori, më shumë se sa skema për të trajtuar popullsinë me gjendjen më të rënduar sociale.** Vendimmarrja qeveritare sa i përket transfereve sociale është e ndikuar nga grupet e interesit, sidomos atyre të ndërlidhura me kategoritë e dala nga lufta. Përderisa skema e ndihmës sociale, si skemë e orientuar për të zbutur varfërinë, ka pësuar rritje të vogël përgjatë viteve, skemat e bazuara në kategori, siç janë pensionet e veteranëve të luftës, pensionet e ish të burgosurve politik, pensionet e familjeve të dëshmorëve, kanë pësuar rritjen më të madhe që nga viti 2008 e këndej.

**Qeveria ende nuk ka aprovuar Strategjinë e re të Punësimit dhe Mirëqenies Sociale.** Punësimi dhe mirëqenia sociale janë pjesë e rëndësishme e dokumenteve strategjike dhe marrëveshjeve të Kosovës me akterët ndërkombëtar, përfshirë: Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asocim dhe Planin Kombëtar për Zbatimin e kësaj marrëveshje, Agjendën për Reforma Evropiane, Programin për Reforma në Ekonomi, Programin Qeverisës 2017-2021, Programin Legjislativ 2017.

**Niveli i zbatimit të këtyre dokumenteve strategjike në përgjithësi, dhe masave të ndërlidhura me politikat e punësimit dhe mirëqenies sociale, në veçanti, është tejet i ulët.** Kjo për arsye se dokumenteve strategjike, akteve ligjore dhe institucioneve u mungon buxheti i mjaftueshëm dhe kapacitetet njerëzore për të realizuar aktivitetet dhe arritur objektivat e caktuara.

**Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021 (SKZH), e cila ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2016, është dokumenti kryesor në fushën e zhvillimit ekonomik.** Shtylla kryesore e kësaj strategjie është kapitali njerëzor, në kuadër të së cilës parashihen edhe masat që kanë të bëjnë me ndërlidhjen më të mirë ndërmjet sistemit të arsimit dhe tregut të punës, si dhe adresimi i punësimit jo formal dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për punë. Përkundër asaj se SKZH parasheh që brenda tre muajve nga aprovimi, të hartohet dhe aprovohet Udhërrëfyesi i cili përcakton hapat e synuar për zbatimin e çdo mase, ai ende nuk ka marrë aprovimin e Qeverisë. Si pasojë, mungesa e këtij udhëzuesi ndikon negativisht në koordinimin e institucioneve, respektimin e afateve kohore dhe arritjen e objektivave.

**Programi Kombëtar për zbatimin e MSA për periudhën 2017-2021 (PKZMSA) parasheh ndryshimin e legjislacionit primar dhe sekondar nga fusha e punësimit dhe mirëqenies sociale me qëllim të transpozimit të direktivave të BE.** Pjesa më e madhe e ligjeve të parapara për ndryshim dhe plotësim, apo aprovimi i ligjeve të reja, nuk kanë marrë ende aprovimin qeveritar. Nga dhjetë aktet nënligjore nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, deri më tani janë aprovuar shtatë.

**Agjenda për Reforma Evropiane (ARE), e aprovuar nga Qeveria në nëntor 2016, përmban aktivitete afatshkurta dy vjeçare.** Një nga tri fushat prioritare në ARE është edhe punësimi dhe arsimit. Sa i përket punësimit, ARE parasheh tri masa për tu përmbushur në periudhën 2016-2017, siç janë aprovimi i Strategjisë sektoriale, hartimi i një plani të veprimit për adresimin e papunësisë së të rinjve, dhe funksionalizimi i Agjencisë së Punësimit. Përveç kësaj të fundit, e cila është funksionalizuar pjesërisht, dy masat e para nuk janë zbatuar ende.

**Programi për Reforma në Ekonomi (PRE) paraqet prioritetet qeveritare në përmbushjen e obligimeve nga MSA në fushën e ekonomisë dhe aprovohet nga Qeveria për çdo vit.** Obligimet kryesore të Kosovës që nga viti 2016 kanë të bëjnë me rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, rritjen e punësimit të të rinjve, themelimin e Agjencisë së Punësimit, dhe uljen e shpenzimeve buxhetore sociale në bazë të kategorive. Ashtu sikurse edhe me dokumentet tjera strategjike, Qeveria ka bërë hapa të pamjaftueshëm në zbatimin e masave të parapara me PRE. Në këtë drejtim, ende nuk ka strategji të veçantë për rritjen e punësimit të grave dhe të rinjve si dy kategoritë me papunësinë më të lartë; premiumet për sigurimet shëndetësore nuk kanë filluar të mblidhen, kurse shpenzimet buxhetore sociale në bazë të kategorive kanë shkuar duke u rritur.

**Programet legjislative të pesë viteve të fundit përmbajnë projektligje të cilat barten nga viti në vit.** Kështu, Ligji i Punës, i cili ka qenë pjesë e programit legjislativ që nga viti 2013, ende nuk është ndryshuar dhe plotësuar. Ngjashëm nuk është plotësuar as Ligji për Këshillin Ekonomiko-Social, përkundër asaj se është përfshirë në programet legjislative që nga viti 2015. Njësoj është vepruar edhe me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin e punës dhe atë për Skemat pensionale të financuara nga shteti.

**Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) është themeluar me Ligjin për APRK, i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2015.** Drejtori i Agjencisë është zgjedhur në prill të 2017, kurse Bordi nuk është emëruar ende. Nuk janë nxjerrë të gjitha aktet nënligjore, të parapara të hartohen brenda gjashtë muajve nga hyrja e ligjit në fuqi.

**Buxheti dhe stafi i APRK për vitin 2018 do të jetë i njëjtë si ai i Departamentit të Punës dhe Punësimit për vitet paraprake.** Buxheti për punë dhe punësim më 2020 do të jetë dukshëm më i vogël se sa buxheti që këto dy divizione kishin në vitet 2011 apo 2013.

**Në kuadër të APRK funksionojnë tetë qendra të aftësimin profesional (QAP), të cilat ofrojnë 26 kurse të ndryshme të aftësimin praktik.** Por, vetëm pesë nga këto profile janë të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Në vitin 2016, kanë ndjekur trajnimet 6,736 persona, e që është një rritje prej 66% në krahasim me vitin 2015. Edhe pse me Agjendën e Reformave Evropiane kërkohet një vlerësim i nevojave të tregut, ende nuk ka një vlerësim zyrtar. Po ashtu, ende nuk është bërë ndërlidhja e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Punësimit (SIMP), i cili menaxhohet nga MPMS, me Sistemin e Menaxhimit të Informatave Arsimore (SMIA), i cili menaxhohet nga MASHT. Buxheti për zgjerimin e masave aktive të tregut të punës ende mbetet i ulët dhe është i pamjaftueshëm për të adresuar nevojat në mënyrë efektive.

**Përveç papunësisë së lartë, edhe të punësuarit përballen me probleme të shumta sa i përket respektimit të kontratave, marrjes së pagave me kohë, standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë.** Numri i inspektorëve dhe kapacitetet logjistike në Inspektoratin e Punës nuk janë të mjaftueshme për të siguruar zbatim të duhur të akteve ligjore nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë. Inspektorati i Punës ka gjithsej 49 inspektorë të ndarë sipas qendrave regjionale, numri i të cilëve në vitin 2017 është më i ulët se ai i vitit 2011 kur ishin 51 inspektorë. Inspektorati ka në dispozicion vetëm 12 automjete, dy më shumë se sa në vitin 2011. Ende nuk është funksionalizuar Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Inspektoratin e Punës.

**Ligji për sigurimin shëndetësor, i cili ka hyrë në fuqi në janar të 2015, ende nuk ka filluar të zbatohet.** Në fund të 2016 është nxjerrë vendim që mbledhja e premiumeve të filloj nga 1 janari 2017, për tu shtyrë për 1 korrik 2017, por që nuk pritet të filloj para gjysmës së dytë të vitit 2018.

**Politika sociale në Kosovë karakterizohet nga transferet e larta monetare dhe nga investime të ulëta sociale.** Institucionet qendrore nuk kanë programe aktive për të moshuarit, siç mund të jenë qendrat rekreative dhe socializuese. Kosova ka vetëm një shtëpi të të moshuarve në gjithë vendin, e cila përballen me kushte të rënda në mungesë të investimeve dhe kujdesit. Përgjatë këtyre viteve është investuar shumë pak në shërbimet sociale, dhe Qendrat për Punë Sociale (QPS) të shpërndara në komunat e Kosovës përballen me mungesë të hapësirave dhe buxhet të pamjaftueshëm për të trajtuar të gjitha rastet në nevojë. Në mungesë të investimeve sociale substanciale, transferet monetare nuk ndihmojnë në tejkalimin e gjendjes së papunësisë afatgjatë, varfërisë dhe nuk ofrojnë ndihmë praktike për personat me aftësi të kufizuara.

**Skema e Ndhmës Sociale është skemë e dizajnuar për të targetuar varfërinë,** por, shumica e kompensimeve mujore dhe mbulueshmëria e familjeve në varfëri është tepër e ulët. Përkundër rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe rritjes së inflacionit, kompensimi për familjet në ndihmë sociale ka mbetur pothuajse i njëjtë. Në vitin 2017, pagesat për familje sillen nga 50 deri 150 euro, shumë e cila nuk është e mjaftueshme për të nxjerrë një individ ose familje nga varfëria. Kështu mbi 70% e familjeve që varen nga ndihmat sociale të kategorisë së parë vazhdojnë të mbesin në varfëri. Nëse bazohemi në të dhënat e varfërisë për vitin 2015, sipas të cilave 17.6% e popullsisë jeton në varfëri me më pak se 1.82 euro në ditë, apo shprehur në numra absolut rreth 317 mijë persona, del se skema e ndihmës sociale mbulon vetëm rreth 34% të popullsisë së varfër.

**Menaxhimi i skemës së pensioneve të veteranëve të luftës së UÇK shpërfaq më së miri dukurinë e presionit të grupeve të interesit në politikat sociale.** Procesi i verifikimit të veteranëve të luftës, i filluar në prill të 2010, nuk ka përfunduar ende. Numri i veteranëve përfitues deri më tani ka arritur në mbi 35 mijë persona, kurse certifikatë të veteranit kanë marrë mbi 46 mijë persona. Listat mund të rriten ngase procesi është ende i hapur. Përkundër kufizimeve se nuk do të tolerohen pagesa më të larta se sa 0.7% e GDP, në vitin 2017 janë shpenzuar mbi 1% e GDP në pensione të veteranëve. Përkundër asaj se të gjithë liderët institucionalë e pranojnë se listat e veteranëve janë të fryera, askush nuk e ka ndalur këtë proces deri në verifikimin e listave. Për më shumë, së paku 2,221 veteranë kanë marrë pensione jashtëligjshëm, pasi që kanë qenë



duke punuar ose kanë përfituar nga së paku dy skema pensionale. Nëse modelojmë buxhetin e pensioneve për 30 vjetët e ardhshme, duke u bazuar në shkallën aktuale të pensionit, numrin e përfituesve, moshën e tyre dhe inflacionin, deri më 2048 do të shpenzohen rreth 2,5 miliardë euro në skemat e pensioneve të veteranëve.

**Nga viti 2018 do të fillojnë pagesat për pensionet e viktimave të torturës dhe dhunës seksuale.** Procesi i verifikimit do të zgjasë pesë vite, nga dita e themelimit të komisionit dhe pritet të përfundojë në vitin 2022. Me Projektbuxhetin për vitin 2018 janë buxhetuar një milion euro për pensionet e viktimave të dhunës seksuale. Kurse në nëntor Qeveria përcaktoi edhe shumën e pensionit prej 230 euro. Bazuar në ndarjet buxhetore, Qeveria nuk pret që numri i viktimave të dhunës seksuale që do të marrin pension të kalojë 350 persona. Nëse vetëm gjysma e viktimave të dhunës seksuale aplikojnë për pension, buxheti vjetor për këtë kategori do të sillet rreth 28 milionë euro.

**Pensionet e moshës dhe ato kontributdhënëse përbëjnë 60% të buxhetit të ndarë për skemat sociale, ose 3.25% të GDP-së së vendit.** Edhe pse ligji parasheh një indeksim të shkallës së pensionit varësisht nga lëvizja e çmimeve të konsumit, një indeksim i tillë automatik nuk ekziston, por bëhet në baza ad hoc. Pensionistët e moshës, të cilët nuk kanë të hyra tjera, përballen me një gjendje më të rënduar sociale. Pensioni i moshës prej 75 euro është i mjaftueshëm për të kaluar kufirin e varfërisë në konsum, por i pamjaftueshëm në rast se llogariten edhe shpenzimet mjekësore dhe shpenzimet për banim. Përfituesit e pensioneve duhet të jenë banorë të përhershëm të Kosovës, por sipas të dhënave zyrtare ka më shumë përfitues se sa popullsia në moshën mbi 65 vjeç.

**Buxheti për pensionet e moshës do të vazhdojë të rritet** në vitet në vazhdim, për shkak se në njërin anë, jetëgjatësia e popullsisë po shkon duke u rritur gjithnjë e më shumë, duke rritur kështu numrin e qytetarëve të cilët do të arrijnë moshën e pensionimit, , ndërsa në anën tjetër, nataliteti në Kosovë është duke shënuar rënie/. Numri i personave në moshë të punës që mbështesin një pensionist do të bie nga 10 sa është sot në vetëm 4 në vitin 2050.

**Shtylla e dytë e sistemit pensional përbëhet nga kursimet e obligueshme pensionale.** Në vitin 2016 ishin 312,672 kontribues aktiv, moshë mesatare e të cilëve ishte 40.7 vite. Për shkak të pagave të ulëta, kontributet pensionale nuk janë të mjaftueshme për të siguruar një pension të mjaftueshëm për një periudhë të gjatë. Bilanci mesatar i kontributeve është 2,795 euro, kurse për kontribuesit aktiv është 3,979 euro. Mesatarisht, kontributpaguesit kanë më pak se 4,000 euro kursime pensionale, apo të hyra prej 200 euro për 20 muaj pas pensionimit. Pas 20 muajsh të gjithë do varen nga pensioni i pleqërisë që e ndanë qeveria.

Dialogu social zhvillohet në kuadër të Këshillit Ekonomiko-Social (KES). KES ka aprovuar pagën minimale në vitin 2011, e cila është 130 euro për personat deri 35 vjeç dhe 170 euro për personat mbi 35 vjeç. Paga minimale është më e vogla në krahasim me vendet e rajonit. KES nuk ka arritur që të gjej pajtueshmëri për të rritur pagën minimale. Marrëveshja kolektive e nënshkruar në fund të vitit 2014 është pezulluar për shkak se nuk është në përputhje me Ligjin e Punës., ndërsa, Ligji i ri për KES nuk është aprovuar ende.

## DUKE U BAZUAR NË KËTO TË GJETURA, RAPORTI REKOMANDON:

- ✓ Aprovimin e Strategjisë për Punësim dhe Mirëqenie Sociale 2018-2022;
- ✓ Aprovimin e Udhërrëfyesit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2021 si dhe publikimin e raportit për zbatueshmërinë e masave që ndërliken me punësimin dhe mirëqenien sociale për vitet 2016-2017;
- ✓ Programi legjislativ për vitin 2018 të përfshij të gjitha aktet ligjore të parapara me Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA, si dhe të aprovohen aktet nënligjore nga fusha e sigurisë në punë të parapara me PKZMSA;
- ✓ Aprovimin e Planit të Veprimit për adresimin e papunësisë së të rinjve;
- ✓ MPMS të hartojë një Plan Veprimi për ndërmarrjen e masave për të rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës;
- ✓ Funksionalizimi i plotë i Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës (APRK), duke emëruar Bordin Këshillëdhënës, hartuar aktet e mbetura nënligjore të parapara me Ligjin për APRK, rritjen e stafit në zyrat e punësimit dhe qendrat e aftësimin profesional dhe rritjen e buxhetit për masat aktive në tregun e punës;
- ✓ APRK të hartojë një dokument zyrtar për Nevojat e Tregut të Punës;
- ✓ Të ngritet numri i inspektorëve të punës dhe kapacitetet logjistike, me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve nga fusha e punës;
- ✓ Të ndahet granti specifik për shërbimet sociale për komuna;
- ✓ Qeveria të kufizojë në 0.7% të GDP-së shumën vjetore për pensionet e veteranëve;
- ✓ MPMS të hartojë një koncept dokumenti i cili parasheh gradualisht shkrirjen e skemave sociale bazuar në kategori, në një skemë të vetme sociale, e cila kriter bazë do të ketë gjendjen sociale.



# 1. Hyrje

Punësimi dhe mirëqenia sociale janë pjesë e portofolios së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Sipas përshkrimit të detyrave, MPMS krijon politikat e punës dhe të mirëqenies sociale si dhe harton dhe zbaton legjislacionin për këto fusha. Gjithashtu, MPMS përcjell ecuritë e punësimit dhe të mirëqenies sociale dhe propozon masat aktive adekuate të nxitjes së punësimit dhe zvogëlimit të papunësisë, si dhe masat pasive adekuate për të përmbushur nevojat e ndihmës sociale për qytetarët nevojtar. MPMS vendos standarde për siguri dhe mbrojtje në punë të të punësuarve dhe mbikëqyr zbatimin e tyre; siguron dhe mbikëqyr programet e aftësimin profesional për të papunët dhe punëkërkesit, nxitë dhe inkurajon dialogun në mes partnerëve social. MPMS administron dhe përkrah zhvillimin e sistemit të sigurimit social, duke përfshirë edhe sistemin pensional dhe benefitet e papunësisë.<sup>1</sup> Por, punësimi dhe mirëqenia sociale bien edhe në portofolin e shumë ministrive tjera, grupeve ndërministrorë dhe komunave.

Me qëllim të trajtimit të problemit të papunësisë, sigurisë dhe shëndetit në punë, luftimin e varfërisë dhe sigurimin e mbështetjes sociale, janë hartuar dokumente të rëndësishme strategjike, akte ligjore dhe nënligjore, janë themeluar institucione, si dhe janë marrë obligime ndërkombëtare përmes dokumenteve të nënshkruara. Një nga zotimet e dhëna në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale është edhe aprovimi dhe zbatimi i Strategjisë së Punësimit dhe Mirëqenies Sociale 2017-2021 (SPMS). Meqenëse ky dokument nuk është aprovuar ende nga Qeveria, edhe pse drafti i SPMS është finalizuar, ky raport vlerëson politikat e punësimit dhe mirëqenies sociale duke u bazuar në objektivat e vendosura me dokumentet tjera strategjike, si: Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH), Agjenda e Reformave Evropiane (ARE), Programet për Reforma në Ekonomi (PRE), Programin e Qeverisë 2017-2021 dhe programin legjislativ.

Pjesa e dytë e raportit jep një vlerësim për zhvillimet e dy viteve të fundit në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale, veçanërisht punësimin e grave dhe të rinjve, si dy grupet me papunësinë më të lartë në Kosovë, funksionalizimin e Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës (APRK) dhe masat aktive në tregun e punës.

Në fushën e mirëqenies sociale, raporti analizon hollësisht skemën e ndihmës sociale, mbulueshmërinë e kategorive të varfra me këtë skemë, mjaftueshmërinë për të nxjerrë ata nga varfëria; si dhe skemën e pensioneve të veteranëve të luftës, si skemë e bazuar në kategori. Kapitulli i mirëqenies sociale analizon edhe punën e Këshillit Ekonomiko-Social dhe dialogun social në përgjithësi, shërbimet sociale dhe familjare dhe skemën për kompensimin e viktimave të torturës dhe dhunës seksuale. Raporti jep një vlerësim edhe të skemës së pensioneve, veçanërisht pensionet e moshës dhe atyre kontributdhënëse, duke analizuar ndikimin buxhetorë, mjaftueshmërinë e pensioneve për të nxjerrë nga varfëria personat në moshë dhe problemet me zbatimin e skemës. Kurse sa i përket kontributeve pensionale në Trustin e Kursimeve Pensionale, raporti jep një pasqyrë të kontributeve të deritanishme dhe mjaftueshmërinë e tyre për të siguruar një pension afatgjatë.

Në fund, me qëllim të adresimit të problemeve të identifikuara, në raport janë dhënë edhe disa rekomandime për institucionet relevante.

Përveç analizimit të dokumenteve strategjike dhe akteve ligjore, në këtë vlerësim janë marrë parasysh edhe raportet e organizatave tjera vendore dhe ndërkombëtare të cilat kanë vlerësuar aspekte të ndryshme të punës dhe mirëqenies sociale. Ndër to edhe raportet e Komisionit Evropian për Kosovën, raportet e Bankës Botërore për papunësinë, raportet e Fondit Monetar Ndërkombëtar për skemat sociale dhe marrëveshja “stand-by” në mes të Republikës së Kosovës dhe FMN, raportet dhe hulumtimet të organizatave vendore, vlerësimet e Korporatës për Sfidat e Mijëvjeçarit (Millennium Challenge Corporation). Gjithashtu janë zhvilluar intervista me akterë relevantë, kryesisht udhëheqës të divizioneve të ndryshme në kuadër të MPMS.

Duke u bazuar në të dhënat zyrtare të institucioneve vendore, si dhe në të dhënat e siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike, raporti përmban projeksione për efektet buxhetore afatgjate që mund të rrjedhin nga ndryshimet e politikave, sidomos skemave sociale. Ky raport është përgatitur përgjatë periudhës shtator-nëntor 2017.

<sup>1</sup> Gazeta Zyrtare, Rregullorja nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Burimi: <http://bit.ly/2xzIzqm>

# KONTEKSTI MAKROEKONOMIK

## 2. Konteksti makroekonomik

Kosova është një ndër vendet më të reja në Evropë sa i përket moshës së popullsisë, ku 66% e popullsisë është në moshë pune dhe ku mosha mesatare e popullsisë është 27 vjeç. Vetëm 8% e popullsisë është në moshën mbi 65 vjeç, shifër kjo e ulët krahasuar me mesataren e vendeve të BE e cila është 19%.<sup>2</sup> Rritja ekonomike vjetore në mesatare është 3.5%, gjersa për vitin 2017 parashikohet një rritje prej 4.4% e GDP (Bruto Produktit Vendor).<sup>3</sup> Edhe pse Kosova ka pasur rritjen më të qëndrueshme në Evropë pas krizës financiare të 2008, rritja nuk ka qenë e mjaftueshme për të gjeneruar punësim. Kosova mbetet vendi më i varfër dhe me papunësinë më të lartë në Evropë.

Konsumi mbetet faktori kryesorë i rritjes ekonomike në vend, i cili financohet kryesisht nga remitencat, pagat dhe transferet sociale.<sup>4</sup> Remitencat arrijnë deri në 750 milionë euro në vit. Por, sipas Ministrisë së Diasporës, nëse merren për bazë edhe të hyrat jo monetare, të hyrat nga diaspora llogariten deri në 1.5 miliardë euro në vit.<sup>5</sup> Por pjesa më e madhe e remitencave shkon për financim të konsumit, kurse vetëm një pjesë e vogël për investime, kryesisht në patundshmëri. Burimet kryesore të rritjes ekonomike të vendit vazhdojnë të jenë shërbimet, bujqësia, ndërtimtaria dhe industria.<sup>6</sup> Kosova karakterizohet me deficit të lartë tregtar i cili është mbi 2.4 miliardë euro. Ndërsa, sektori i vetëm i cili ka bilanc pozitiv tregtar janë shërbimet.

Në 2017, ekonomia joformale vlerësohet të jetë 31.7%.<sup>7</sup> Krahasuar me shkallën e ekonomisë jo formale të 2014, ekonomia jo formale ka arritur të tkurret për vetëm 1%, progres shumë i ulët krahasuar me objektivin e Qeverisë për të ulur shkallën e ekonomisë jo formale për 5% deri më 2018.<sup>8</sup> Vlerësohet se në sektorin joformal punojnë më shumë se 45,000 punëtorë të ekuivalentes së punëtorit me orar të plotë, ku 33.2% e të ardhurave personale për ekonomitë familjare është joformale.

Sa i përket madhësisë së ndërmarrjeve, rreth 91% e ndërmarrjeve në Kosovë janë mikro ndërmarrje, të cilat punësojnë më pak se sa 10 punëtorë. Kosova ka një shkallë të ulët të investimeve të huaja direkte në krahasim me vendet e rajonit. Më 2016 ishin 215.9 milionë euro, një rënie e madhe nga viti 2015, kur shënuan 308.8 milionë euro.<sup>9</sup> Arsyet e shkallës së ulët të investimeve të huaja kanë të bëjnë me tregun e vogël, nivelin e lartë të korrupsionit, mos njohja nga shumica e shteteve dhe stabiliteti politik.<sup>10</sup> Të dhënat e fundit të varfërisë tregojnë një rënie të varfërisë nga 29.7% sa ishte në vitin 2011, në 17.6% në vitin 2015; kurse për të njëjtën periudhë varfëria ekstreme ka rënë nga 10.2% në 5.2%.

2 World Bank. Republic of Kosovo – Systemic Country Diagnostic. January 2017. Burimi: <http://bit.ly/2AJwPfs>

3 World Bank. Western Balkans Regular Economic Report no.12. 2017. Burimi: <http://bit.ly/2BmsJX3>

4 Millennium Challenge Corporation. Kosovo Constraints Analysis. November 2017.

5 Agron Demi. Fuqia e Shumëfishitë e Diasporës. Kallxo.com, 18 korrik 2017. Burimi: <http://bit.ly/2j0tEFK>

6 ASK. Bruto Produkti Vendor 2008-2016. Burimi: <http://bit.ly/2nefwgG>

7 Asistenca Teknike e BE për Kosovë. Vlerësim mbi shtrirjen e ekonomisë jo formale në Kosovë. Nëntor 2017.

8 Qeveria e Kosovës. Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018. Janar 2014.

9 Banka Qendrore e Kosovës. Investimet e huaja direkte – sipas zërave financiar. Gusht 2017.

10 Millennium Challenge Corporation. Kosovo Constraints Analysis. November 2017.

# AGJENDA QEVERITARE NË FUSHËNË E PUNËSIMIT DHE MIRËQENIES SOCIALE



### 3. Agjenda qeveritare në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale

Punësimi dhe mirëqenia sociale zënë vend të rëndësishëm në programet e çdo qeverie dhe në strategji të ndryshme qeveritare. Nga 431 ligje në fuqi deri në fund të nëntorit 2017, 34 ligje janë nga fusha e punësimit dhe mirëqenies sociale; nga 1,986 akte nënligjore, 139 zbatohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS); nga 57 strategji që janë në fuqi, 4 bien në fushën e mirëqenies sociale. Duke marrë parasysh se politikat e punësimit dhe mirëqenies sociale janë pjesë e portofolieve të disa ministrive, janë krijuar së paku edhe shtatë komisione (grupe) ndërministrore.

Përveç dokumenteve të brendshme, politikat e punësimit dhe mirëqenies sociale janë zotime që janë marrë përsipër nga Qeveria e Kosovës në disa marrëveshje me institucionet ndërkombëtare, siç janë Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim (MSA), Agjenda për Reforma Evropiane (ARE), Programi për Reforma në Ekonomi (PRE), Marrëveshja “Stand-by” me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), etj.

#### 3.1. Punësimi dhe mirëqenia sociale me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2021

Dokumenti kryesor në fushën e zhvillimit ekonomik është Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021<sup>11</sup> (SKZH), e aprovuar në shkurt të vitit 2016. Parim i përgjithshëm i SKZH është rritja ekonomike që nënkupton rritje të të ardhurave, rritje të punësimit dhe të mirëqenies për qytetarët e Kosovës. Në bazë të këtij parimi, janë vendosur prioritetet dhe masat për periudhën afatmesme gjashtë vjeçare. Në kuadër të shtyllës së parë të strategjisë, e cila trajton Kapitalin Njerëzor, janë paraparë edhe masat dhe aktivitetet konkrete, të cilat kryesisht ndërlidhin aftësimin profesional me sistemin arsimor. Masat të cilat ndërlidhen më shumë me punën dhe mirëqenien sociale janë:

-  **Masa 3:** Ndërlidhja më e mirë ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës;
-  **Masa 7:** Adresimi i punësimit jo formal dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për punë.

Menjëherë pas aprovimit të SKZH, Qeveria kishte hapur një platformë online në internet, e cila menaxhohej nga Zyra për Planifikim Strategjik, në të cilën do publikoheshin informata rreth SKZH, Udhërrëfyesit dhe zbatimin e masave.<sup>12</sup> Por kjo faqe është jashtë funksionit.<sup>13</sup>

SKZH parasheh që brenda tre muajve nga aprovimi, të hartohet dhe aprovohet Udhërrëfyesi i cili detajon hapat e synuar për zbatimin e çdo mase. Një draft i Udhërrëfyesit është hartuar në prill 2017, 14 muaj pas aprovimit të SKZH. Ky udhërrëfyes është aprovuar nga Komisioni për Planifikim Strategjik, por nuk ka arritur që të marrë aprovimin qeveritar për shkak të zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Mos aprovimi i Udhërrëfyesit e bën të vështirë koordinimin institucional për zbatimin e masave, ndarjen e buxhetit dhe monitorimin e objektivave.

11 Qeveria e Kosovës. Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomik 2016-2021. Burimi: <http://bit.ly/2iBli3S>.  
12 Përshkrimi i detyrave të Zyrës për Planifikim Strategjik, Burimi: <http://bit.ly/1OhNLnO>  
13 [www.plan-rks.org](http://www.plan-rks.org)

Sipas Draft-Udhëzuesit, zbatimi i Strategjisë në nivel operacional do të monitorohet në baza gjashtë mujore nëpërmjet Planit Vjetor të Punës së Qeverisë; arritja e objektivave në nivelin e masave do të monitorohet në baza vjetore; kurse ndikimi i SKZH do të matet nëpërmjet krahasimit të treguesve të nivelit të lartë në periudhën 6 vjeçare, aq sa SKZH do të jetë në fuqi.<sup>14</sup> Deri më tani nuk ka ndonjë raport monitorues gjashtë mujorë apo një vjeçar për shkak të mos aprovimit të Udhërrëfyesit.

Në Udhërrëfyesin për zbatimin e SKZH janë vendosur edhe treguesit e niveli të lartë, apo caqet që duhet të arrihen deri në vitin 2021 në fushën e zhvillimit ekonomik, tregun e punës, kohezionin social, investime dhe tregti. Treguesit për tregun e punës dhe kohezionin social janë paraqitur në tabelën 1. Në kolonën e fundit (Treguesi 2017) kemi vlerësuar progresin e arritur në dy vitet e para nga hyrja në fuqi e SKZH.

**Tabela 1.** Treguesit kryesorë për tregun e punës dhe kohezionin social sipas draft-Udhëzuesit të SKZH

Masa	Treguesi	Njësia e Matjes	Treguesi Bazë		Treguesi i Synuar 2021	Treguesi 2017
			Viti	Vlera	Vlera	Vlera
Tregu i Punës	Përqindja e punësimit kundrejt numrit të popullsisë (niveli i punësimit)	%	2015	25.2%	34%	29.9%*
	Papunësia në total (% kundrejt fuqisë së aftë për punë)	%	2015	32.9%	20%	30.6%
	Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	%	2015	57.7%	30%	50.9%
	Përqindja e të rinjve që nuk ndjekin arsimin apo trajnimin, në total, NEET (% kundrejt totalit të popullsisë në moshë të re)	%	2015	31.4%	25%	27.1%
	Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë së aftë për punë	%	2015	37.6%	42%	43%
	Shkalla e pjesëmarrjes së grave në forcat e punës	%	2015	18.1%	27%	20%
Kohezioni Social	Shkalla e varfërisë (% e popullsisë së varfër ndaj totalit të popullsisë)	%	2011	29.9%	25%	17.6%**
	Indeksi i Zhvillimit Human	Index	2015	0.741	0.80	0.741***

Burimi: Bazuar në Udhërrëfyesin për zbatimin e SKZH  
\*Sipas AFP për TM2 2017  
\*\*Varfëria në konsum 2012-2015  
\*\*\*UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2016.

14 Qeveria e Kosovës – Zyra për Planifikim Strategjik. Udhërrëfyes për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2021 (Draft). Hartuar në prill 2017.

### 3.2. Punësimi dhe Mirëqenia Sociale me Marrëveshjen për Stabilizim Asociim

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016. Në fund të vitit 2015, Qeveria ka miratuar Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA për vitin 2016; kurse më 10 mars 2017 ka miratuar Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA (PKZMSA) për periudhën 2017-2021<sup>15</sup>. Nenet 82 dhe 106 të MSA trajtojnë politikat sociale dhe punësimin. Për të transpozuar direktivat e BE për politikat sociale dhe punësimin të parapara me Kapitullin 19 të Acquis, në periudhën afatmesme Qeveria ka vënë si objektivi ndryshimin e katër ligjeve dhe aprovimin e dhjetë akteve nënligjore. Deri në nëntor 2017, Qeveria nuk ka aprovuar ndryshimet në Ligjin e punës, Ligjin për shërbimet sociale dhe familjare, Ligjin për grevat dhe Ligjin për Këshillin Ekonomiko-Social. Nga 10 rregulloret e parapara për aprovim, 7 janë aprovuar.

**Tabela 2.** Veprimet e parapara në fushën e politikave sociale dhe punësimit sipas PKZMSA

## Kapitulli 19 i *acquis* -së: Politikat sociale dhe punësimi

Afati	Aktet ligjore që duhet harmonizuar me direktivat e BE	Realizimi
2016	Ligji Nr. 03/L -212 i Punës (plotësim -ndryshim)	Jo
2016	Ligji Nr. 04/L -008 për Këshillin Ekonomiko - Social (plotësim -ndryshim)	Jo
2016	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë për përdorim e pajisjeve personale nga të punësuarit	Rregullorja ka hyrë në fuqi në nëntor 2016.
2016	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë për trajtimin manual të ngarkesave ku ka rrezik veçanërisht nga lëndimi i shpinës për punëtorët	Rregullorja ka hyrë në fuqi në nëntor 2016.
2016	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë për pajisjet me ekran	Rregullorja ka hyrë në fuqi në dhjetor 2016.
2016	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë për shenjat në vendet e punës	Rregullorja ka hyrë në fuqi në nëntor 2016.
2016	Hartimi i Rregullores mbi me kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë të të punësuarve në industritë e mineral - nxjerrjes përmes shpimit	Jo
2016	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë mbrojtjen e punëtorëve në industrinë e minerale - nxjerrjes nëntokësore dhe në sipërfaqe	Jo
2016	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë të të punësuarve potencialisht në rrezik nga ambientet shpërthyes	Rregullorja ka hyrë në fuqi në dhjetor 2016.
2016	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë me ekspozimin e të punësuarve ndaj rreziqeve nga dridhja	Rregullorja ka hyrë në fuqi në mars 2017.
2016	Hartimi i Rregullores mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë në lidhje me ekspozimin e të punësuarve ndaj rreziqeve nga zhurma	Rregullorja ka hyrë në fuqi në mars 2017.
2016	Hartimi i Rregullores mbi mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbestit në vendin e punës	Jo

15 Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA. Burimi: <http://bit.ly/2yetU9R>

### 3.3. Punësimi dhe mirëqenia sociale me Agjendën për Reforma Evropiane

Përderisa MSA është një dokument strategjik afatgjatë, Agjenda për Reforma Evropiane (ARE), e aprovuar nga Qeveria më 9 nëntor 2016, përmban aktivitete afatshkurta dy vjeçare. Tri fushat prioritare në Agjendën për Reformën Evropiane janë: sundimi i ligjit, konkurrenca dhe ambienti i investimeve, si dhe punësimi dhe arsimiti. Sa i përket punësimit, ARE parasheh tri masa për periudhën 2016-2017.

**Tabela 3.** Masat në punësim sipas ARE

Masat	Aktivitetet dhe indikatorët	Afati kohorë	Progresi		
Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Sektoriale për Punësim dhe Mirëqenie Sociale 2015-2020 dhe Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë për 2017-2018	1. Strategjia sektoriale hartohet dhe del në konsultime;	Q4 2016	Strategjia është hartuar.		
	2. Aprovohet Strategjia;	Q2 2017	Strategjia nuk ka marr aprovimin qeveritar dhe rrjedhimisht nuk është ndarë buxhet.		
	3. Alokohet buxheti për zbatim të strategjisë.				
a. Hartimi i një plani të veprimit për adresimin e papunësisë së të rinjve;	a.1. Hartimi i Planit të Veprimit me indikatorë të qartë;	Q4 2016	Plani i Veprimit është hartuar, por nuk ka marr aprovimin qeveritar dhe nuk është ndarë buxhet.		
	a.2. Draft i Planit konsultohet me akterët relevant;	Q1 2017			
	a.3. Aprovohet Plani i Veprimit.	Q1 2017			
	b. Ndërmarrja e masave për të rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës	b.1. Gratë marrin ndihmë më të madhe nga qendrat e punësimit		Q1 2017	
		b.2. Hartohet analiza për vështirësitë që hasin gratë në punësim;		Q4 2016	Jo
		b.3. Analiza përdoret për të ndërmarr hapa konkret për rritjen e punësimit të grave.		Q3 2017	

### Masat

	Aktivitetet dhe indikatorët	Afati kohorë	Progresi
Funksionalizimi i Agjencisë së Punësimit, përmes zbatimit të plotë të ligjit dhe ndarjes së buxhetit adekuat	1. Kryhet Vlerësimi i Nevojave të Tregut të Punës;	Q1 2017	Nuk ka vlerësim zyrtarë. Agjencia e Punësimit bazohet në vlerësimet e organizatave dhe bizneseve.
	2. Përzgjidhet Drejtori dhe Bordi i Agjencisë së Punësimit dhe aprovohen rregulloret e punës së Agjencisë;	Q4 2016	Pjesërisht, është përzgjedhur drejtori dhe janë aprovuar disa akte nënligjore, por nuk është përzgjedhur Bordi.
	3. Zbatimi nga Agjencia i masave aktive në tregun e punës.	Q2 2017	Vazhdimësi nga vitet e kaluara

Strategjia e re Sektoriale për Punësim dhe Mirëqenie Sociale nuk është aprovuar ende. Gjithashtu, nuk është hartuar plani për adresimin e papunësisë së të rinjve e as nuk janë ndërmarrë masa të veçanta për të rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Sa i përket funksionalizimit të Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës (APRK), është përzgjedhur drejtori dhe është bërë bartja e pjesërishme e stafit nga Departamenti i Punës dhe Punësimit, por ende nuk është emëruar Bordi Këshillëdhënës dhe nuk janë aprovuar të gjitha aktet nënligjore të parapara me Ligjin për APRK. Buxheti i APRK dhe numri i të punësuarve nuk kanë pësuar rritje nga vitet paraprake.

### 3.4. Punësimi dhe mirëqenia sociale me Programin për Reforma në Ekonomi

Programi për Reforma në Ekonomi (PRE) paraqet prioritetet qeveritare në përmbushjen e obligimeve nga MSA në fushën e ekonomisë dhe aprovohet nga Qeveria për çdo vit. Përmes PRE, obligimet kryesore të Kosovës që nga 2016 kanë të bëjnë me rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, rritjen e punësimit të të rinjve, themelimin e Agjencisë së Punësimit, dhe uljen e shpenzimeve buxhetore sociale në bazë të kategorive.<sup>16</sup>

PRE i fundit është ai i vitit 2017, përderisa Qeveria ka hapur konsultimet për PRE 2018. Dy nga 20 masat e vendosura në PRE 2017 kanë të bëjnë me punësimin dhe politikat sociale:

✓ **Masa 19:** Përmirësimi i shërbimeve të punësimit nëpërmjet funksionalizimit të Agjencisë për Punësim dhe zbatimit të masave aktive të tregut të punës;

✓ **Masa 20:** Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe shëndetësore.

Tabela 4 paraqet aktivitetet sipas masave të PRE 2017, ku në kolonën e djathtë është bërë një vlerësim për zbatueshmërinë e aktiviteteve deri në fund të nëntorit 2017.

<sup>16</sup> European Commission. Joint Conclusions on Economic Reform Programs. Brussels, 25.5.2016. Burimi: <http://bit.ly/1TE9Lz1>



**Tabela 4.** Aktivitetet me PRE në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale

## Masa 19: Përmirësimi i shërbimeve të punësimit

Aktivitetet për vitin 2017	Progresi
Krijimi formal i APRK-së, duke përfshirë bartjen e stafit ekzistues dhe asetëve nga MPMS;	Po
Hartimi i rregullores për Bordin këshillëdhënës si dhe hartimi i akteve të nevojshme nënligjore	Nuk është përzgjedhur Bordi dhe nuk është hartuar rregullorja.
Licencimi i ofruesve jopublikë të shërbimeve të punësimit për të përmirësuar ofrimin e masave të punësimit (për zbatimin e masave aktive të tregut të punës)	Është aprovuar udhëzimi administrativ i ri për licencimin e ofruesve jo publik të shërbimeve të punësimit.
Trajnimi i këshilltarëve të punësimit dhe shqyrtimi i rezultateve të performancës	Trajnim i vazhdueshëm i rreth 109 trajnerëve nga donatorë të ndryshëm (GIZ, YES, UNDP).
Përmirësimi i Integritetit të Sistemit Informativ të Tregut të Punës (SITP) me Sistemin e Menaxhimit të Informatave Arsimore (SMIA)	Jo
Modernizimi i shërbimeve të ofruara të aftësimin profesional	/

## Masa 20: Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe shëndetësore

Krijimi dhe dizajnimi i formulës së financimit për shërbimet sociale dhe familjare (minimum 6% e Grantit të Përgjithshëm për shërbime sociale)	Jo
Përfshirja e “grantit specifik për shërbimet sociale” në kuadër të sistemit të financimit të komunave nga ana e qeverisë qendrore, duke e inkuadruar atë në ndryshim-plotësimin e Ligjit të Financave Lokale	Ndryshimi i Ligjit për financat e pushtetit lokal ka filluar në pjesën e parë të vitit 2017, por nuk është aprovuar ende.
Mbështetja me grante për OJQ-të e licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare	Në total për periudhën 2015-2016, MPMS ka ndarë mbi 1.9 milionë euro në subvencione, por vetëm një pjesë shkon për OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale, pjesa tjetër shkon për shoqatat e dala nga lufta apo odat e bizneseve.
Zhvillimi, mbështetja dhe financimi i ndërmarrjeve sociale që ofrojnë shërbime sociale	Në tetor 2017 është aprovuar Projektligji për ndërmarrjet sociale.
Zhvillimi dhe avancimi i Sistemit të Integruar Informativ të Pagesave Sociale, që po ashtu përfshin statistika të ndara në baza gjinore	Jo
Mbledhja e premieeve të sigurimeve shëndetësore nga qytetarët; mbulimi i kostos së premieeve për kategoritë sociale nga buxheti i Kosovës.	E paraparë që të filloj në janar 2017, është shtyrë për në fund të 2018.

Kurse, me PRE 2018, e cila pritet të aprovohet në muajin janar të vitit të ardhshëm parashihen dy masa në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale:

- ✓ **Masa 24:** Rritja e qasjes së të rinjve dhe grave në tregun e punës;
- ✓ **Masa 25:** Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe shëndetësore e cila synon fuqizimin e sistemit të mbrojtjes sociale dhe shërbimeve shëndetësore nëpërmjet përcaktimit të sistemit të qëndrueshëm për financimin e shërbimeve sociale, si dhe krijimin e fondit të sigurimeve shëndetësore.

### 3.5. Punësimi dhe mirëqenia sociale me Programin qeverisës 2017-2021

Viti 2017 ishte vit zgjedhor. Fillimisht në qershor 2017 u mbajtën zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare kurse në tetor dhe nëntor zgjedhjet lokale. Si në çdo fushatë zgjedhore paraprake, edhe këtë vit partitë politike dhanë premtime të shumta nga fusha e punësimit, mirëqenies sociale dhe pensione. Ndër të tjera partitë të cilat tani janë pjesë e koalicionit qeverisës, premtuan rritje të pensioneve për 30%, krijimin e një Fondi për të Rinjtë dhe Gratë, uljen e varfërisë në zonat rurale, funksionalizimin e Fondit për Sigurime Shëndetësore, punësimin e një anëtari nga çdo familje, e tjera.

Më 18 shtator 2017, Qeveria aprovoi Programin Qeverisës 2017-2021. Në kuadër të programit qeverisës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) për periudhën e ardhshme katër vjeçare parashihet objektivat si në vijim:

- ✓ Rritjen e punësimit përmes masave aktive të tregut të punës;
- ✓ Punësimin e një anëtari për çdo familje që nuk e kanë asnjë të punësuar;
- ✓ Ofrimin e shërbimeve të aftësimin profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës;
- ✓ Avancimin e kushteve të punës të punëtorëve dhe luftimin e punësimit jo formal;
- ✓ Dialogun social dhe ngritja e kapaciteteve të Këshillit Ekonomiko-Social;
- ✓ Fuqizimin e organizatave jo qeveritare përmes procesit të licencimit dhe sigurimit të një fondi për financimin e projekteve për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare;
- ✓ Zhvillimin e formulës së financimit dhe grantit specifik për shërbimet sociale në nivel komunal;
- ✓ Ri-shikimin e skemave të aftësisë së kufizuar;
- ✓ Reformimin e sistemit pensional;
- ✓ Sigurimin e të drejtave të kategorive të dala nga lufta me fokus zbatimin e legjislacionit për këto kategori.



Programi i qeverisë ende nuk ka marrë aprovimin e Kuvendit. Përderisa shumica e objektivave të përfshira në Programin qeverisës janë objektiva të cilat janë bartë nga vitet e kaluara ose janë të përfshira në dokumentet strategjike, objektivi për punësimin e një anëtari nga çdo familje është objektivi i ri, i cili është bartur nga fushata zgjedhore e partive politike tashmë pjesë e koalicionit qeverisës. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), nga 297 mijë familje në Kosovë, 121 mijë prej tyre nuk kanë asnjë të punësuar. Një objektivi si ky, përmban dy probleme kryesore: e para, hapja e 121 mijë vendeve të reja të punës për një mandat katër vjeçarë qeverisës është e pamundur me këtë trend të rritjes ekonomike; e dyta, edhe sikur të hapeshin 121 mijë vende të reja të punës, kriteri i “punësimit të një anëtari për çdo familje” bie ndesh me parimin e meritokracisë dhe të drejtën e punëdhënësve për të angazhuar fuqi punëtore në bazë të aftësive të tyre.

### 3.6. Programi legjislativ i qeverisë

Për shkak të zgjedhjeve parlamentare, Programi legjislativ i Qeverisë për vitin 2017 është aprovuar dy herë. Por të dy programet përmbajnë listën e njëjtë të projektligjeve nga fusha e punësimit dhe mirëqenies sociale: Projektligji për ndërmarrjet sociale, Projektligji për inspektoratin e punës dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti. Deri në fund të nëntorit 2017 në nivel të ekzekutivit është aprovuar vetëm Projektligji për ndërmarrjet sociale.

Gjatë katër viteve të fundit janë aprovuar tri ligje nga fusha e punësimit dhe mirëqenies sociale.<sup>17</sup> Por ligjet e rëndësishme, të parapara edhe me PKZMSA, siç janë ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit të punës dhe Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social nuk kanë shkuar ende në Kuvend për aprovim. Projektligji i Punës ka qenë pjesë e programeve legjislative për vitet 2013, 2014 dhe 2015, por nuk është përfshirë në programet legjislative në dy vitet e fundit. Ndërsa, Projektligji për KES ka qenë pjesë e programeve legjislative të viteve 2015 dhe 2016, por është larguar nga programi legjislativ i vitit 2017.

17 Ligji për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuarve dhe punëdhënësve; Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara; Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet pensionale të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe me ligjin nr.04/L-168.

**Tabela 5.** Projektligjet e sponsorizura nga MPMS në programet legjislative 2013-2017

Projektligji	Programi Legjislativ					Aprovuar nga:	
	2013	2014	2015	2016	2017	Qeveria	Kuvendi
Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit të Punës	✓	✓	✓			✗	✗
Projektligji për Agjencinë e Punësimit	✓					✓	✓ (12.12.2013)
Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara	✓		✓			✓	✓ (23.8.2016)
Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social			✓	✓		✗	✗
Projektligji për Ndërmarrjet Sociale në Kosovë				✓	✓	✓ (27.10.2017)	✗
Projektligji për Inspektoratin e Punës				✓	✓	✗	✗
Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti				✓	✓	✗	✗

### 3.7. Struktura institucionale

Punësimi dhe politikat sociale janë kompetencë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). MPMS bën pjesë në grupin e parë të ministrive të themeluara në vitin 2001. Struktura e saj është pothuajse e njëjtë që nga themelimi. Ndryshimin më të madh strukturor MPMS e ka pasur pas themelimit të Agjencisë së Punësimit në të cilin është shkrirë pjesërisht Departamenti për Punë dhe Punësim (DPP).


Punësimi dhe politikat sociale janë pjesë të së njëjtës portofolio ministrore në shumë vende të Evropës.<sup>18</sup> Por, punësimi dhe politikat sociale kanë ndërlidhje të ngushtë edhe me zhvillimin ekonomik, arsimin dhe shëndetësinë. Në vitin 2009, Projekti i Rishikimit Funkcional dhe Organizimit Institucional të Ministrive (FRIDOM), propozonte krijimin e një ministrie të zhvillimit ekonomik, në të cilën do të bartej edhe punësimi nga MPMS. Sipas projektit, në kontekstin e Kosovës lidhja ekonomi-punësim duket më e rëndësishme sesa punësim-mirëqenie sociale.<sup>19</sup> Por largimi i politikave të punësimit nga MPMS rekomandohej vetëm nëse krijohet një ministri e vetme e zhvillimit ekonomik në të cilën do të shkriheshin edhe ministrinë tjera. Në anën tjetër, përkundër asaj se përgatitja profesionale ndërlidhet me arsimin, kurse mirëqenia sociale me shëndetësinë, nuk rekomandohej që këto funksione të kalohen në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), respektivisht Ministrinë Shëndetësisë (MSH), për shkak të portofolios së gjerë që kanë këto dy ministri.

Siç vërehet nga dokumentet e ndryshme strategjike të përshkruara më sipër, punësimi është i ndërlidhur ngushtë me arsimin (në SKZH, punësimi është pjesë e masave që hyjnë në ‘Kapitalin njerëzor’), kurse mirëqenia sociale është e ndërlidhur me shëndetësinë (në PRE, në kuadër të politikave sociale hyn edhe sigurimi shëndetësorë). Në nivel lokal, mirëqenia sociale është e ndërlidhur me shëndetësinë, ku në çdo komunë këto politika janë pjesë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Përkundër rekomandimeve të shumta që të krijohet një ministri e vetme e zhvillimit ekonomik dhe të ulet numri i ministrive<sup>20</sup>, pas vitit 2008 qeveritë kanë shtuar në vazhdimësi numrin e ministrive. Pas konstituimit të Qeverisë së Kryeministrit Ramush Haradinaj në shtator 2017, numri i ministrive ka arritur në 21, duke u shtuar edhe për tri numri i ministrive të zhvillimit ekonomik: Ministria e Ndërmarrjes dhe Inovacionit, Ministria e Zhvillimit Rajonal, Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike. Në total, janë nëntë ministri që mbulojnë sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Për shkak të numrit të madh të ministrive dhe për faktin se disa ministri mbulojnë portfolion e njëjtë, shfaqet nevoja e krijimit të grupeve ndërministrorë. Në periudhën 2008-2016, Qeveria ka themeluar 38 komisione të ndryshme ndërministrorë, ku MPMS bën pjesë në së paku 17 prej tyre.

Figura 1. Pjesëmarrja e MPMS në grupet ndërministrorë



18 Ministria e Sigurisë Sociale dhe Punës në Lituanë; Ministria e Punës, Familjes dhe Çështjeve Sociale në Slloveni; Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Familjes në Sllovaki; Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale në Estoni, e tjera.

19 FRIDOM. Rishikimi funksional i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. 2009.


20 Instituti GAP. Ristrukturimi i Qeverisë. 2014. Burimi: <http://bit.ly/1vjlfxo>

Burimi: Punuar me Graph Commons, bazuar në vendimet e Qeverisë 2008-2016

Për shkak se komisionet ndërministrare përbëhen nga më shumë se pesë ministri, paraqitet sfida në koordinimin e agjendave për aranzhimin e takimeve, edhe në rastet kur përfaqësimi në komisionet ndërministrare është në nivel të zyrtarëve të departamenteve të ministrive.


MPMS ka buxhet vjetor nën menaxhim më shumë se çdo ministri tjetër. Sipas Projektbuxhetit për vitin 2018, MPMS do të ketë buxhet prej më shumë se 407 milionë euro.

**Figura 2.** Projektionet buxhetore për 2018 sipas ministrive



Buxheti i MPMS për 2018 është rritur për 152% në krahasim me buxhetin e vitit 2009.

**Figura 3.** Buxheti i MPMS 2009-2020



Rritja më e madhe e buxhetit të MPMS në dekadën e fundit ka ndodhur në kategorinë e pensioneve bazë, pensioneve të kontributdhënësve, kategoritë e dala nga lufta dhe pensionet e ish të dënuarve politikë. Ndërsa buxheti për shërbimet e punësimit dhe aftësimin profesional, ndihmat sociale, shërbimet sociale dhe inspektoratin e punës ka mbetur thuajse i njëjtë, ose me rritje minimale.

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Zbatimi i Ligjit për viktimat e dhunës seksuale												
Pensionet bazike-sociale	60,248,071	65,743,489	66,592,818	72,989,888	82,388,924	89,836,507	119,099,640	119,550,488	114,202,807	116,276,788	117,136,788	121,704,308
Pensionet e aftësisë së kufizuar	10,582,304	11,857,974	13,299,927	13,344,759	12,695,759	12,683,202	15,113,314	18,315,000	19,700,000	19,700,000	12,000,000	17,000,000
Pensionet e Trepces	2,903,760	2,683,100	3,612,829	3,612,829	3,414,600	3,414,600	4,114,000	4,610,000	4,310,888	4,300,000	4,300,000	4,300,000
Pensionet e TMK	1,422,900	2,572,900	2,572,900	2,572,900	1,224,000	1,224,000	2,016,000	2,506,000	2,650,000	2,600,000	2,600,000	2,600,000
Pensionet kontributive	24,844,464	29,750,000	37,000,000	41,700,000	47,897,475	47,897,475	68,633,800	91,683,800	89,713,800	89,891,647	90,291,647	90,291,647
Pensionet e FSK				648,049	631,200	631,200	800,000	800,000	1,200,000	1,300,000	1,300,000	1,300,000
Financimi i deputetëve të viteve '90									300,000	300,000	300,000	300,000
Kompensimi për të burgosurit politik							10,500,000	10,500,000	10,500,000	10,500,000	10,500,000	10,500,000
Kompensimi për të verbërit							3,944,888	3,944,888	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000
Pensionet familjar									2,880,000	2,880,000	2,880,000	2,880,000
Pensionet invalidor i punës										1,800,000	1,800,000	1,800,000
Pensionet për invalidët e luftës së UÇK	20,452,856	21,751,102	30,079,143	30,777,143	29,605,024	30,593,227	40,763,640	37,833,691	38,005,675	38,160,325	37,160,325	37,160,325
Pensionet e veteraneve												
Ndihma sociale	28,309,208	28,617,451	28,783,700	28,664,339	28,448,274	27,851,335	26,138,685	30,594,956	27,427,080	31,426,880	32,426,880	32,426,880
Shërbimet sociale	3,651,072	2,849,022	3,463,088	4,545,657	3,784,383	3,926,016	4,757,250	4,718,697	4,760,937	4,730,485	4,730,485	4,730,485
Pagesat për komunalit për rastet sociale								4,500,000	4,500,000	4,500,000	4,500,000	4,500,000
Shërbimet e punësimit	1,240,888	2,225,620	9,912,065	5,170,677	6,154,318	4,383,511	4,378,288	4,100,948	5,099,019	5,198,479	5,528,928	5,419,002
Shërbimet e aftësisë profesionale	804,331	2,172,638	2,167,091	1,982,468	2,232,468	1,769,426	1,480,760	1,105,463	1,508,576	1,132,287	1,187,561	1,267,561
Inspektorati i punës	352,935	496,355	565,072	506,572	511,572	517,187	561,436	566,583	590,716	621,907	621,907	621,907

## Skemat



Figura 4. Buxheti i MPMS 2009-2020 sipas skemave

MPMS është ndër ministritë e pakta që në dhjetë vitet e fundit ka ulje të numrit të të punësuarve dhe jo rritje. Përderisa numri i përgjithshëm i të punësuarve në administratën shtetërore në fund të vitit 2016 ishte për 4,624 të punësuar më shumë në krahasim me 2009, numri i të punësuarve në MPMS në fund të 2016 është për 442 të punësuar më pak se sa në vitin 2009. Një nga arsytet për këtë është edhe decentralizimi i shërbimeve sociale, ku një pjesë e stafit të MPMS është bartur tek komunat.

Tabela 6. Numri i të punësuarve në disa nga njësitë e MPMS (2009-2018)<sup>21</sup>

Njësitë e MPMS	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Pensionet dhe kompensimet	177	177	177	177	177	177	177	178	180	180
Ndihmat sociale	12	12	12	12	12	12	12	11	11	11
Shërbimet sociale	17	17	17	17	24	24	24	24	24	24
Shërbimet e punësimit	201	201	201	201	201	201	201	213	215	215
Shërbimet e aftësisë profesionale	92	92	92	97	97	97	97	90	92	92
Inspektorati i punës	60	60	60	65	65	65	65	70	70	70
Shërbimet e Administratës	69	78	78	79	79	78	78	88	88	88
Tjera	669	291	288	282	290	290	267	176	175	175
Total	1297	928	925	930	945	944	921	850	855	855


Burimi: Ligjet e Buxhetit 2009-2016

Ministria e Financave publikon klasifikimet buxhetore çdo vit. Në vitin 2016, klasifikimi buxhetor për mbrojtje sociale përbënte 22.05% të të gjitha shpenzimeve buxhetore, apo 386 milionë euro.

<sup>21</sup> Të dhënat e punësimit të marra nga Ligjet e Buxhetit paraqesin kufirin maksimal të të punësuarve dhe mund të ndryshojnë nga raportet financiare buxhetore.

**Figura 5.** Kategorizimi i ndarjeve buxhetore sipas Ministrisë së Financave për vitin 2016

## Buxheti i Kosovës - Klasifikimi funksional



Burimi: Instituti GAP



Në pjesën e dytë të këtij raport do të vlerësohet progresi në arritjen e objektivave të vendosura në dokumentet e ndryshme strategjike të shtjelluara më sipër në fushën e punësimit, mirëqenies sociale, pensioneve dhe dialogut social.

## 4. Tregu i punës

Informatat për tregun e punës në Kosovë janë përmirësuar dukshëm. Nga viti 2012 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rregullisht Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP) për çdo vit, kurse dy vitet e fundit rezultatet e AFP publikohen çdo tre muaj. Të dhënat e ASK për tregun e punës plotësohen edhe nga të dhënat e Agjencisë së Punësimit (ish-Departamenti i Punës dhe Punësimit në MPMS) për punëkërkesit e regjistruar dhe masat aktive në tregun e punës; si dhe të dhënat e Fondit të Kursimeve Pensionale (Trusti) për të punësuarit në sektorin formal. Në anën tjetër, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) nuk publikon të dhëna rreth të punësuarve të cilët paguajnë tatimet në këtë institucion.

Sipas të dhënave të AFP, papunësia në tre mujorin e dytë të 2017 është 30.6%, një ngritje e papunësisë në krahasim me vitin 2016 (27.5%), por pothuajse në nivel të njëjtë me papunësinë e regjistruar në vitin 2012 (30.9%). Por, për shkak se të dhënat tre mujore të papunësisë ofrojnë lëvizje të mëdha brenda vitit dhe nuk janë të krahasueshme me një vit të plotë, do të shërbehemi me të dhënat e fundit vjetore të papunësisë, ato të 2016.


**Figura 6.** Pjesëmarrja në fuqinë punëtore, shkalla e papunësisë dhe raporti punësim/popullsi 2012-2016



Burimi: AFP, 2012-2017.

Në pesë vitet e fundit, popullsia në moshë pune është në nivel thuhet të njëjtë, rreth 1.2 milionë. Por edhe më tej shkalla e inaktivitetit, apo personave në moshë pune që nuk kërkojnë punë, mbetet ende e lartë. Kosova ka shkallën më të lartë të inaktivitetit në krahasim me të gjitha vendet e Evropës. Fuqia punëtore (persona aktiv) në 2016 ishte më e ulët se sa më 2013 dhe 2014, përkundrazi asaj se popullsia në moshë pune ishte më e lartë se në çdo vit para 2016.

**Figura 7.** Relacioni në mes të popullsisë në moshë pune, fuqisë punëtore dhe të punësuarve 2012-2016




Përkundër lëvizjeve të vogla pozitive në shkallën e papunësisë, vendet neto të punës janë më të vogla se sa në vitin 2013, një rënie prej gati 2%. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, në periudhën mes vitit 2005 deri 2014 janë krijuar vetëm 63,000 vende të reja të punës neto.<sup>22</sup> Por edhe këto vende të punës janë më shumë vende pune si rrjedhojë e formalizimit të ekonomisë, se sa si vende të reja pune.<sup>23</sup> Sa i përket kohëzgjatjes së papunësisë, 65.6% e të papunëve kanë raportuar se janë të papunë për periudha më të gjata se sa një vit.

Vërehen dallime të mëdha sa i përket orëve të punës dhe pagës në sektorin privat dhe atë publik. Përderisa sipas Ligjit të Punës, orari javor i rregullt i punës nuk duhet të kalojë 40 orë në javë, 83.2% e të punësuarve punojnë më shumë se sa 40 orë në javë. Të punësuarit në sektorin publik marrin pagë mesatare mujore prej 554 euro në muaj, kurse orari mesatar i punës është 32 orë në javë; kurse të punësuarit në sektorin privat marrin pagë mesatare mujore prej 416 euro në muaj, me orar mesatar të punës prej 48 orë në javë. Kurse shumica e pagave mujore neto bien në mes të 300 dhe 400 euro në muaj. Dallime të mëdha në mes të sektorit privat dhe publik vërehen edhe sa i përket kohëzgjatjes së pushimit të lehonisë, ku gratë në sektorin publik mesatarisht marrin pushim të lehonisë në kohëzgjatje prej nëntë muaj e dy javë, përkundrejt shtatë muaj e tri javë të pushimit të lehonisë për gratë në sektorin privat.<sup>24</sup>

Nga 331,761 vendet e punës, 22.9% prej tyre janë vende të paqëndrueshme, apo persona të vetëpunësuar ose të punësuar pa pagesë në biznese familjare.<sup>25</sup> Viteve të fundit vërehet një shkallë më e lartë e punësimit të paqëndrueshëm.

22 World Bank. Jobs Diagnostic – Kosovo. Jobs Series, Issue No.5. 2017.  
23 Asistenca Teknike e Bashkimit Evropian për Kosovën. Vlerësim mbi shtrirjen e ekonomisë joformale në Kosovës, nëntor 2017 (Projekt i zbatuar nga Business and Strategies Europe).  
24 Riinvest. Gratë në tregun e punës – analizë e kushteve të punës për gratë në Kosovë. 2017. Burimi: <http://bit.ly/2jipKe8>  
25 AFP, 2016.

**Figura 8.** Punësimi i paqëndrueshëm 2012-2016



Edhe më tej rreth 45,000 vende të punës konsiderohen të jenë në sektorin jo formal, pjesa më e madhe e tyre në sektorin e bujqësisë (24,000 vende), ndërtimtarisë (9,778 vende) dhe në sektorin e tregtisë.<sup>26</sup> Të rinjtë, më pak të arsimuar dhe ata nga zonat rurale janë më të prirë që të angazhohen në ekonominë joformale. Të punësuarit në sektorin jo formal fitojnë 18% më pak se sa ata në sektorin formal, kurse të punësuarit me kontrata fitojnë 28% më shumë se sa ata pa kontrata.<sup>27</sup>

Pjesa më e madhe e të punësuarve (36%) punësohen në mikro-ndërmarrje, të cilat përbëjnë 91% të ndërmarrjeve aktive në Kosovës, kurse firmat e mëdha, ato që punësojnë mbi 100 punonjës, edhe pse të pakta në numër (0.5% e të gjitha ndërmarrjeve në Kosovë), punësojnë 35% të punonjësve. Rreth 35% e ndërmarrjeve janë të koncentruara në Prishtinë. Po ashtu, më shumë se gjysma e të punësuarve në Kosovë (54%) janë të punësuar në Prishtinë. Këtu mund të ketë ndikim të madh edhe përqendrimi i institucioneve administrative shtetërore.


#### 4.1. Pjesëmarrja e grave në tregun e punës

Përderisa sigurimi i një vendi të qëndrueshëm të punës është sfida për të gjithë popullsinë në moshë të punës në Kosovë, vështirësitë janë edhe më të mëdha për gratë, të rinjtë dhe pjesëtarët e komuniteteve pakicë. Edhe pse numri i grave dhe burrave në moshë pune është thajse i barabartë (49% gra dhe 51% burra në moshë të punës), dallime të mëdha vërehen në shkallën e aktivitetit dhe punësimit. Mbi 81% e grave në moshë pune nuk janë aktive në tregun e punës. Shkalla e jo aktivitetit tek gratë ka mbetur e njëjtë pothuajse përgjatë të gjitha viteve.

26 Asistenca Teknike e Bashkimit Evropian për Kosovën. Vlerësim mbi shtrirjen e ekonomisë joformale në Kosovës, nëntor 2017 (projekt i zbatuar nga Business and Strategies Europe).  
27 World Bank. Jobs Diagnostic – Kosovo. Jobs Series, Issue No.5. 2017. Burimi: <http://bit.ly/2AjPwpe>



**Figura 9.** Gratë jo aktive në tregun e punës 2012-2016




Burimi: AFP, 2012-2016

Arsyet më të shpeshta që përmenden nga gratë për mos pjesëmarrjen në tregun e punës janë arsyet familjare, për dallim nga burrat të cilët arsye kryesore përmenden edukimin/trajnimin ose humbjen e besimit për të siguruar një vend pune. Kujdesi ndaj fëmijëve dhe të moshuarve ende mbetet përgjegjësi e grave. Kosova ka shkallën më të ulët në Evropë për pjesëmarrjen e fëmijëve në institucione parashkollore (vetëm 2%).<sup>28</sup>

Vetëm 12.6% e grave në moshë të punës janë të punësuar. Në pesë vitet e fundit të dhënat dëshmojnë se asnjëherë punësimi i grave nuk ka qenë më i lartë se sa 12.8%.

28 World Bank. Jobs Diagnostic - Kosovo. Jobs Series, Issue No.5. 2017. Burimi: <http://bit.ly/2AjPwpe>

**Figura 10.** Shkalla e punësimit të grave 2012-2016



Burimi: AFP, 2012-2016.

Gratë përbëjnë 44.2% të të papunëve të regjistruar më 2016, por shkalla e ndërmjetësimit në punësim të grave është shumë më e ulët se sa ajo e burrave (38.5% në krahasim me 61.5%). Nga 6,736 praktikantë të cilët ndjekin kurse të aftësimi profesional në qendrat e aftësimi, vetëm 27.2% janë gra. Të dhënat e arsimit të lartë viteve të fundit tregojnë shkallë më të lartë të pjesëmarrjes së grave të reja në të gjitha nivelet e arsimit, si dhe shkallë më të lartë të diplomimit.<sup>29</sup>

Punëdhënësit vlerësojnë ndryshe aftësitë e punonjësve gra dhe burra. Fusha e vetme ku bizneset vlerësojnë gratë të jenë më kompetente se sa burrat janë njohuritë në gjuhët e huaja. Por përkundër kësaj, burrave u jepen mundësi më të mëdha për të ndjekur trajnime se sa grave. Gratë dhe burrat punojnë në sektorë të ndryshëm. Pjesa më e madhe e grave (2/3) punojnë në sektorin publik ose në sektorin e shitjeve. Gratë paguhet mesatarisht 11% më pak se burrat për të njëjtën pozitë pune dhe me të njëjtat përgatitje profesionale.<sup>30</sup> Rreth 30% e grave punojnë pa kontratë dhe me punë jashtë orarit për të cilën nuk paguhet.<sup>31</sup>

29 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2015/2016. Burimi: <http://bit.ly/2zOHZQ2>

30 World Bank. Jobs diagnostic. 2017

31 Riinvest. Gratë në tregun e punës-analizë e kushteve të punës për gratë në Kosovë. 2017. Burimi: <http://bit.ly/2ijpKe8>

Punëdhënësit, si në sektorin privat, ashtu edhe në sektorin publik, përdorin profilizim gjinor me rastin e shpalljes së konkurseve të punës, zakonisht duke preferuar gratë për pozita më të ulëta në hierarkinë e punës, dhe duke favorizuar burrat për pozita menaxheriale.<sup>32</sup>

Përveç faktorëve të mësipërm, edhe përzgjedhja e profesionit ndikon në shanset për të gjetur një vend pune. Gratë kanë më shumë tendencë që të studiojnë për shkencat sociale dhe për profesionet që kanë të bëjnë me edukim dhe shëndetësi. Në të njëjtën kohë, papunësia më e lartë e regjistruar është tek profesionet e ndërlidhura me shkencat sociale, kurse punësimi më i lartë tek profesionet që mund të angazhohen në sektorin e shërbimeve.<sup>33</sup>

Me qëllim të zbutjes së dallimeve në punësim në mes të grave dhe burrave, nevojiten masa të veçanta për fuqizimin e grave. Përkundër asaj se me ARE, Qeveria ka marrë obligim që të hartojë një analizë për vështirësitë që hasin gratë në punësim, një analizë e tillë zyrtare ende nuk ekziston. Po ashtu, sipas ARE parashihet që qendrat e punësimit të japin ndihmë më të madhe për gratë në punësim, por të dhënat zyrtare tregojnë një shkallë shumë më të ulët të ndërmjetësimit në punësim për gratë se sa për burrat.

Duke marrë parasysh se janë kryer analiza të shumta nga organizata vendore dhe ndërkombëtare për pengesat që hasin gratë për pjesëmarrje në tregun e punës, MPMS dhe APRK duhet të shfrytëzojnë këto analiza dhe të fillojnë adaptimin e masave të veçanta sa i përket punësimit të grave.


## 4.2. Punësimi i të rinjve

Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, por njëkohësisht edhe papunësinë më të lartë të të rinjve të moshës 15 deri 24 vjeç. Papunësia në mesin e të rinjve është 52.4%, një rënie prej 8.6 % krahasuar me vitin 2014 kur papunësia në mesin e të rinjve ishte 61%.

32 Instituti GAP. Diskriminimi në tregun e punës – ndikimi i konkurseve në pabarazinë gjinore. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2qijwCP>

33 Social Impact. Kosovo Labor Force and time use study – Research Report – Executive Summary. November 2017. (raporti i përgatitur për nevojat e MCC në Kosovë, drafti final i të cilit pritet të publikohet në mars 2018).

Figura 11. Shkalla e papunësisë tek të rinjtë 2012-2016




Burimi: AFP, 2012-2016

Një ndër arsytet e rënies së papunësisë tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeç në dy vitet e fundit mund të jenë edhe rënia e informalitetit, ku të rinjtë përbëjnë pjesën më të madhe të të punësuarve, si dhe rritja e emigrimit në tri vitet e fundit. Në periudhën 2014-2016 azil nga Kosova në vendet e BE-së kanë kërkuar 110,165 kosovarë, 71% e tyre në moshë pune, kurse 53% në moshën 14 deri 34 vjet.<sup>34</sup>

34 Eurostat. Burimi: <http://bit.ly/1dBAzYR>

**Figura 12.** Emigrantët sipas moshës



Burimi: Eurostat

Sipas të dhënave të MPMS, nga numri i përgjithshëm i të papunëve të regjistruar më 2016, vetëm 16.2% e tyre ishin në mes të moshës 15-24 vjeç; kurse nga numri i përgjithshëm i atyre që ndjekin aftësimin profesional, 36.5% janë në këtë grupmoshë. Të rinjtë e papunë të cilët njëkohësisht nuk ndjekin shkollën apo ndonjë trajnim përbëjnë 30.1% të të papunëve të rinj. Nga totali prej 312,672 kontributpaguesve aktivë në Trust, të rinjtë përbëjnë vetëm 13.4% të kontribuesve, gjersa kontributi mesatar i tyre është 25.77 euro në muaj, kontributi më i ulët në krahasim me të gjitha grupmoshat.<sup>35</sup>

ARE parashih hartimin dhe aprovimin e një plani të veprimit për punësimin e të rinjve, por ky plan nuk ka marrë ende aprovimin e Qeverisë.<sup>36</sup>

<sup>35</sup> Trusti i Kursimeve Pensionale. Raporti vjetor 2016. Burimi: <http://bit.ly/2AkgfzV>

<sup>36</sup> Në fillim të muajit nëntor, MPMS dhe MASHT kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me organizatën gjermane GIZ për projektin "Rinia, Punësimi dhe Aftësimi e Arsimit Profesional në Kosovë".


### 4.3. Funksionimi i Agjencisë së Punësimit

Nga janari i vitit 2015 është në fuqi Ligji për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës.<sup>37</sup> Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) është organ i pavarur në kuadër të MPMS. Edhe pse me ligj parashihej që brenda gjashtë muajsh nga hyrja e ligjit në fuqi të nxjerrën aktet nënligjore, aprovimi i tyre ka filluar vetëm në dhjetor të 2015.

Departamenti për Punë dhe Punësim i cili ka ekzistuar deri më tani në kuadër të MPMS, është bartur tek APRK, përveç Divizionit për Politikën e Punësimit i cili do të mbetet edhe më tej në kuadër të MPMS. Në bazë të Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës<sup>38</sup>, në kuadër të APRK do të funksionojë Departamenti për Tregun e Punës me 10 të punësuar dhe Departamenti për Aftësim Profesional me shtatë të punësuar.

Në kuadër të APRK janë edhe 38 zyre të punësimit në të gjitha komunat e Kosovës, me gjithsej 160 të punësuar, si dhe tetë qendra rajonale të aftësimin profesional me 90 të punësuar.

**Figura 13.** Organogrami i Agjencisë së Punësimit



<sup>37</sup> Gazeta Zyrtare. Ligji nr.04/L-205 për Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës. Burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8983>


<sup>38</sup> Qeveria e Kosovës. Rregullore nr.13/2015 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë e Punësimit, aprovuar më 8 dhjetor 2015.

Drejtori i Përgjithshëm i APRK është zgjedhur më 5 prill 2017 me një mandat tre vjeçar.<sup>39</sup> Por konkursi për Drejtor të APRK ishte shpallur më 13 prill 2017, tetë ditë pas emërimit. Sipas Ligjit për Agjencinë e Punësimit, posti i Drejtorit të Përgjithshëm bën pjesë në shërbimin civil dhe ai duhet të zgjidhet sipas procedurave të parapara me Ligjin për Shërbimin Civil. Pas ankesave, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShCK) në shkresën e 24 prillit 2017 drejtuar Zyrës së Kryeministrit ka kërkuar pezullimin e vendimit për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të APRK. Zyra e Kryeministrit nuk ka marrë asnjë veprim, me arsyetimin se përzgjedhja e drejtorit të APRK është bërë nga një kompani profesionale angleze, në bazë të Memorandumit të nënshkruar në mes të Ambasadës së Britanisë së Madhe në Prishtinë, Zyrës së Kryeministrit dhe Kuvendit të Kosovës. Sipas Memorandumit, institucionet pajtohen që procesin e rekrutimit për pozita kyçe në institucione ta lënë në dorë të një kompanie të huaj e cila angazhohet nga Ambasada.

Ligji për APRK parasheh edhe përzgjedhjen e Bordit Këshillëdhënës prej nëntë anëtarësh, i cili takohet së paku gjashtë herë në vit, por i cili nuk është emëruar ende nga Qeveria.

APRK do të ketë numër të njëjtë të të punësuarve që kanë ekzistuar edhe para krijimit të Agjencisë kur kanë funksionuar në kuadër të DPP. Po ashtu, buxheti i APRK për 2008 do të jetë thuhet i njëjtë me buxhetin e viteve paraprake, kurse parashihet një rritje shumë e vogël për vitet 2019-2020. Buxheti për punë dhe punësim më 2020 do të jetë dukshëm më i vogël se sa buxheti i këtyre dy divizioneve më 2011 apo 2013.

**Figura 14.** Buxheti i dy divizioneve më të rëndësishme të Departamentit/Agjencisë së Punësimit (2009-2020)



39 Qeveria e Kosovës. Vendimi n.08/140, i datës 5 prill 2017. Burimi: <http://bit.ly/2zRnput>

Buxheti i ndarë nga donatorët për politikën e punësimit dhe aftësimi profesional është më i madh se sa ai i ndarë nga Buxheti i Kosovës. Sipas llogaritjeve të MPMS, donatorët shpenzojnë deri 7.5 milionë euro në vit, kryesisht fonde të IPA-s dhe Bankës Botërore.<sup>40</sup>

Rregullorja për organizimin e brendshëm të APRK vendos numrin maksimal të të punësuarve në secilin divizion dhe zyre. Sipas Rregullores, numri maksimal i të punësuarve do të jetë 285. Ky është numër më i ulët se sa numri maksimal i lejuar me Projektbuxhetin 2018, që është 307.

Përkundër asaj se APRK do të ketë kompetenca dhe pavarësi më të madhe se sa Departamenti i cili ka funksionuar më herët, numri i të punësuarve dhe buxheti i APRK nuk japin shumë shpresë se do të ketë ndryshim pozitiv sa i përket shërbimeve të punësimit dhe aftësimi profesional.

#### 4.3.1. Funksionimi i Qendrave të Aftësimi Profesional

Përkundër niveleve të larta të papunësisë, Kosova përballet edhe me problemin e papunësisë strukturore, apo vështirësinë e bizneseve për të angazhuar forcë të kualifikuar punëtoare. Edhe pse me ARE kërkohet një vlerësim i nevojave të tregut, ende nuk ka një vlerësim zyrtar. APRK pret që ky vlerësim të bëhet nga organizatat hulumtuese, asociacionet e bizneseve dhe donatorët.<sup>41</sup> Në të kaluarën MPMS ka ndarë buxhet për asociacionet e bizneseve që të kryejnë hulumtime për nevojat e tregut.<sup>42</sup> Hulumtime të shumta të organizatave të ndryshme dëshmojnë për problemet me të cilat përballen punëkërkuarit sa i përket shkathtësive të punëtoareve.

Në tetor 2017 Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) publikoi një analizë për mungesën e fuqisë punëtoare.<sup>43</sup> Sipas raportit të OEK, mbi 80% e ndërmarrjeve të anketuara kanë problem të gjejnë punëtoarë të kualifikuar. Kurse vetëm 35.8% deklarojnë se janë të kënaqur me shkathtësitë e punëtoarëve që i kanë të angazhuar. Sektori i ndërtimit, prodhimit dhe shërbimeve kanë nivel më të ulët të kënaqshmërisë me punëtoarët e angazhuar. Vetëm 18.1% e ndërmarrjeve të anketuara kanë deklaruar se kanë bashkëpunim të herë pas herëshëm me qendrat trajnuese dhe ato të punësimit.

Sipas anketës, 15 profesionet më të kërkuara nga bizneset janë: kontabilist, hulumtues tregu, agjent distributor i shitjes, furnizues për stoqet e mallrave, saldues, dizajner i enterierit, teknolog i ushqimit, operues dhe serviser i makinave prodhuese, kuzhinier, elektro/hidro/termo instalues, automekanik, strukturues metali, përpunues i drurit, dizajner i tekstilit. Për pesë nga këto profesione të kërkuara ofrohen trajnime në kuadër të QAP-ve. Por problem mbetet cilësia e trajnimeve, mungesa e bashkëpunimit në mes të bizneseve dhe QAP-ve, si dhe informimi jo i mirë për trajnimet që ofrohen.

Të gjeturat e anketës së OEK konfirmohen edhe nga analiza tjera. Sipas një serie të analizave të Institutit GAP me prodhuesit e lëngjeve të frutave, letrës, materialit ndërtimor dhe prodhuesit e qumështit, profesionet më të kërkuara janë saldues, teknolog i ushqimit, elektrikist, mirëmbajtës të makinerisë, grafist për shtyp, etj.<sup>44</sup> Gjithashtu, një raport më gjithëpërfshirës i UNDP konstaton se një numër i madh i bizneseve në fushën e turizmit, përpunimit të metaleve, drurit, tekstilit, përballen me vështirësi në angazhimin e punonjësve me shkathtësi adekuate.<sup>45</sup>

40 MPMS. Politikën e punësimit për Shërbimet Publike të Punësimit 2016-2018. Janar 2016.

41 Intervistë me Drin Haraçija - Drejtor i APRK. Intervista e Zhvilluar më 10 nëntor 2017.

42 Në vitet 2015-2016, MPMS ka ndarë 57,231 euro subvencione për asociacionet e bizneseve. Burimi: Raporti për Mbështetjen financiare publike për OJQ-të nga institucionet e Republikës së Kosovës 2015-2016. Mars 2017.

43 Oda Ekonomike e Kosovës. Mungesa e fuqisë punëtoare të kualifikuar - sfida për bizneset. Prishtinë, 2007, (me financim të agjencisë gjermane - GIZ).

44 Instituti GAP. Seria e analizave me prodhuesit vendorë, 2016. Burimi: <http://bit.ly/1Svo7B5>

45 UNDP Kosovo. Vlerësimi i nevojave për shkathtësi: identifikimi i nevojave të punëdhënësve në gjashtë sektorë ekonomikë në Kosovë. Nëntor 2016. Burimi: <http://bit.ly/2ijhvPf>

Sektori i shërbimeve është sektori me rritjen më të madhe në Kosovë. Por edhe bizneset në sektorin e shërbimeve përballen me vështirësi të shumta në angazhimin e punonjësve të kualifikuar. Sipas një ankete me bizneset në sektorin e shërbimeve, 82.1% e bizneseve kanë hasur vështirësi në gjetjen e punëtorëve të kualifikuar. Rreth 53% e bizneseve të anketuara në këtë sektor kanë deklaruar se janë detyruar që të angazhojnë punëtorë më pak të kualifikuar. Për shkak të fuqisë punëtore të pakualifikuar, 57.1% e bizneseve kanë deklaruar se është penguar zhvillimi i produkteve të reja dhe 42.1% janë shprehur se kjo ka ndikuar në uljen e produktivitetit.<sup>46</sup> Mbi 48% e bizneseve të cilat punësojnë më shumë se dhjetë punëtorë kanë raportuar se kanë vështirësi më të mëdha në angazhimin e punëtorëve të kualifikuar.<sup>47</sup>

Raporti i Bankës Botërore për vendet e punës në Kosovë identifikon dy probleme kryesore të cilat pengojnë rritjen e bizneseve: ambienti jo i përshtatshëm i të bërit biznes dhe mospërputhja në mes të vendeve të punës dhe shkathtësive të punëtorëve.<sup>48</sup> Ka mungesë të fuqisë punëtore të specializuar në marketing, shitje dhe dizajnim të produkteve dhe kjo e vështirëson konkurrencën e bizneseve vendore në tregjet ndërkombëtare. Vështirësia më e madhe e bizneseve është punësimi i personave me përvojë të punës. Bizneset në pronësi të huaj dhe bizneset inovative kanë vështirësi më të mëdha në punësim se sa bizneset vendore. Bizneset nuk kanë besim tek institucionet arsimore dhe qendrat trajnuese për përgatitjen e punonjësve. Një numër i madh i bizneseve kanë shprehur pakënaqësi në qendrat e aftësimi profesional, si dhe mungesën e bashkëpunimit në mes të shkollave profesionale, universiteteve dhe bizneseve. Për shkak të kësaj, dy të tretat e bizneseve rekrutimet i bëjnë në mënyrë informale, përmes kontakteve apo rekomandimeve.

Në kuadër të MPMS funksionojnë tetë qendra të aftësimi profesional, të cilat ofrojnë kurse të ndryshme të aftësimi praktik. Këto qendra dallojnë nga arsimiti profesional, i cili ofrohet nga MASHT për nga kohëzgjatja dhe metodat. Një nga masat e parapara me PRE 2017 është edhe ndërlikdhja e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Punësimit (SIMP), i cili mirëmbahet nga MPMS, me Sistemin e Menaxhimit të Informatave Arsimore (SMIA), i cili mirëmbahet nga MASHT. Por deri më tani nuk ka ndodhur një ndërlikdhje e këtyre dy sistemeve.

46 Instituti GAP. Paraditja profesionale për tregun e punës - analizë e sektorit privat të shërbimeve. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2qSVo13>  
47 Kosovo SME Promotion Programme. Report on SMEs in Kosovo 2014. Burimi: <http://bit.ly/2AjJz9p>  
48 World Bank. Jobs Diagnostic - Kosovo. Jobs Series, Issue No.5. 2017.

**Tabela 7.** Kurset që ofrohen nga qendrat e aftësimi profesional

**Gendrat e Aftësimi profesional dhe kurset e aftësimi që ofrojnë**

Prishtinë	Prizren	Gjilan	Ferizaj	Mitrovicë	Mitrovicë (Dolan)	Gjakovë	Pejë
Furrтари	Kuzhinier	Teknologji informative	Teknologji informative	Teknologji informative	Teknologji informative	Teknologji informative	Ndërtimtari
Pastiqeri	Kamarier	Dizajn grafik	Instalime elektrike	Administrim biznesi	Administrim biznesi	Kontabilitet	Instalime elektrike
Punë zyre	Auto-elektrikë	Zdrukthëtari	Ndërtimtari	Tekstil	Tekstil	Instalime elektrike	Hidroinstalime
Kontabilitet	Hidraulikë dhe pneumatikë	Metal	Hidroinstalime	Metal	Metal	Administrim biznesi/ Vetëpunësim	Përpunim të produkteve bujqësore
Riparim i pajisjeve të zyrës	Saldim	Administrim biznesi/ Vetëpunësim	Saldim	Zdrukthëtari	Zdrukthëtari	Saldim	Punë zyre
Administrim biznesi	Elektronikë industriale		Vetëpunësim	Ndërtimtari	Ndërtimtari		Vetëpunësim
Instalim të ujit dhe ngrohjes	Administrim biznesi/ Ndërmarrësi		Mirëmbajtës objektësh	vetëpunësim	Kuzhinieri		Administrim biznesi/ Ndërmarrësi
Auto-elektronikë	Riparim të teknikës së bardhë		Administrim biznesi/ Ndërmarrësi				
Ndërtimtari	Teknologji informative						
	Përpunim të qumështit						


Vetëm pesë nga profilet e lartcekura janë të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK).<sup>49</sup> Në vitin 2016, në tetë QAP-ët kanë ndjekur trajnimet 6,736 persona, e që është një rritje prej 66% në krahasim me vitin 2015.<sup>50</sup>

Aftësimi profesional është vetëm një nga masat aktive në tregun e punës. Zyrat e punësimit ofrojnë edhe masa aktive të punës për të papunët e regjistruar, të cilat përfshijnë subvencionimet në punësim, trajnim në punë, aftësim profesional, praktikë në punë, vetëpunësim dhe promovim i ndërmarrësisë, etj.<sup>51</sup> Ligji parasheh edhe nxjerrjen e udhëzimit

49 INDEP. Aftësimi profesional në Kosovë: specifikat, marrëdhëniet dhe problemet. 2016. Burimi: <http://bit.ly/2j0JtFJ>  
50 MPMS. Puna dhe Punësimi - Raport 2016. Burimi: <http://bit.ly/2AgvFXB>  
51 Gazeta Zyrtare. Ligji nr.05/L-077 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve për të papunët, punëkërkuarit dhe punëdhënësit. Burimi: <http://bit.ly/2i2zqWu>

administrativ i cili përcakton mënyrat për ofrimin e masave aktive në tregun, por edhe pas më shumë se një viti nga hyrja e ligjit në fuqi nuk ka hyrë në fuqi një akt i tillë nënligjorë.<sup>52</sup>

**Figura 15.** Numri i përfituesve sipas llojeve të masave aktive në tregun e punës (2015-2016)



Burimi: APRK, Puna dhe Punësimi 2016

Sipas PKZMSA, buxheti për zgjerimin e masave aktive të tregut të punës ende mbetet i ulët dhe është i pamjaftueshëm për të adresuar nevojat në mënyrë efektive. Përkundër pranimin të këtij fakti, buxheti për masat aktive në tregun e punës mbetet thuajse i njëjtë edhe për vitet në vazhdim. Kjo pjesë mbulohet më shumë nga donatorët ndërkombëtarë se sa nga buxheti i shtetit.

Për të përmbushur misionin e tyre të aftësimin profesional, QAP-ët nevojitet që të zgjerojnë fushën e trajnimeve duke përfshirë lëmi të trajnimit të cilat kërkohen më shumë nga punëdhënësit. Gjithashtu, nevojitet licencimi i programeve,

me qëllim që ato të jenë të pranueshme si për bizneset vendore ashtu edhe për tregun ndërkombëtarë. Për më shumë, nevojitet rritja e bashkëpunimit në mes të QAP me institucionet arsimore dhe asociacionet e bizneseve. Përkundër asaj se pas themelimit të APRK ka një informim më të mirë sa i përket funksionimit të QAP-ve, nevojitet të investohet më shumë në marketing, dhe rritja e prezencës në mediat sociale.

#### 4.3.2. Ndërmjetësimi në punësim

Në vitin 2016 ishin 101,773 punëkërkuar të regjistruar, një rënie prej 9.3% në krahasim me vitin 2015. Nga numri i përgjithshëm i punëkërkuarve, 55.7% janë burra, kurse 44.3% janë gra. Sa i përket kualifikimit, 37.3% e punëkërkuarve janë pa ndonjë kualifikim, ndërsa rreth 8% e punëkërkuarve janë me kualifikim universitar, prej të cilëve, 7,826 kanë të mbaruar studimet bachelor, ndërsa 401 kanë kryer studimet master. Sa i përket grupmoshës, numri më i madh i punëkërkuarve, rreth 48.3% i takon grupmoshës 25-39 vjeç, dhe 27.9% i takon grupmoshës 40-54.<sup>53</sup>

Nga viti i kaluar, me funksionalizimin e APRK, ka filluar edhe regjistrimi online i punëkërkuarve në platformën e APRK. Punëkërkuarët e regjistruar në këtë formë janë përdorues të shërbimeve të ofruara online, por jo të shërbimeve të ofruara nga zyrat e punësimit.<sup>54</sup>

Punëkërkuarët që paraqiten në zyrat e punësimit regjistrohen në SIMP dhe profilizohen në njërin nga këto tri nëngrupe: grupi me rrezik të ulët për tu bërë të papunë afatgjatë, grupi me rrezik të mesëm dhe grupi me rrezik të lartë. Varësisht nga klasifikimi, punëkërkuarët marrin edhe këshillat nga këshilltari/ja në zyrat e punësimit. Në raportet e MPMS për punën dhe punësimin nuk jepen të dhëna se sa nga punëkërkuarët janë regjistruar në grupin e parë, apo me rrezikshmëri të ulët të papunësisë afatgjatë, sa me rrezikshmëri të mesme dhe sa me rrezikshmëri të lartë. Përkundër këtyre ndryshimeve pozitive në regjistrimin e të papunëve, kapacitetet e zyrave komunale të punësimit kanë mbetur thuajse të njëjta. Sipas Rregullores për organizimin e brendshëm të APRK, në 12 Zyra të Punësimit në 12 komuna janë të punësuar vetëm dy persona, një udhëheqës i zyrës dhe një asistent/e.

Në bazë të kualifikimeve dhe rreziqeve për papunësinë afatgjatë, zyrat e punësimit mund t'i orientojnë punëkërkuarët në ndjekjen e një a po më shumë trajnimeve në QAP. Por, sipas një ankete të zhvilluar nga INDEP, vetëm 8% e atyre që kanë ndjekur trajnimet në QAP kanë dëgjuar ose janë drejtuar tek QAP-ët nga zyrat e punësimit.<sup>55</sup>

Në anën tjetër, gjatë vitit 2016 tek qendrat e punësimit janë regjistruar 14,137 vende të lira pune, apo një ngritje prej 22.9% në krahasim me vitin 2015. Pjesa më e madhe e vendeve të punës janë lajmëruar nga mikro ndërmarrjet. Por përkundër këtyre vendeve të lira të punës dhe numrit të madh të punëkërkuarve, zyrat e punësimit kanë arritur që të ndërmjetësojnë punësimin e vetëm të 4,022 personave, kurse 2,732 persona të tjerë janë angazhuar përmes masave aktive të tregut të punës. Shkalla e punësimit përmes qendrave të punësimit për vitin 2016 është vetëm 6,6%. Edhe pse një ngritje e lehtë nga viti i kaluar, shkalla e punësimit mbetet tejet e ulët.

52 Në prill të 2012 ka hyrë në fuqi Udhëzimi administrative nr.01/2012 për programet aktive në tregun e punës, por i cili bazohet në Ligjin e shfuqizuar nr.04/L-083 për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuarve.

53 MPMS. Puna dhe Punësimi - Raport 2016. Burimi: <http://bit.ly/2AgvFXB>

54 MPMS. Puna dhe Punësimi - Raport 2016.

55 INDEP. Aftësimi profesional në Kosovë: specifikat, marrëdhëniet dhe problemet. 2016.



#### 4.4. Siguria në punë

Përveç papunësisë së lartë, edhe të punësuarit përballen me probleme të shumta sa i përket respektimit të kontratave, marrjes së pagave me kohë, standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Përkundër asaj se me Ligjin e punës orari i rregullt i punës është 40 orë në javë, 83% e të punësuarve punojnë më shumë se 40 orë në javë, prej tyre 15.9% më shumë se 60 orë në javë.<sup>56</sup> Rreth 45,000 persona janë të punësuar në sektorin joformal, të cilët janë pa kontrata dhe pa garanci ligjore për siguri në punë.<sup>57</sup>

Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe aktet nënligjore përcjellëse vendosin standardet minimale të sigurisë në punë në sektorë të ndryshëm. MPMS ka aprovuar numrin më të madh të akteve nënligjore nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë të parapara me PKZMSA. Por zbatueshmëria e ligjeve dhe akteve nënligjore është tejet e ulët. Kjo edhe për faktin se Inspektorati i Punës (IP), si trupë ekzekutive përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së legjislacionit në fushën e punës, ka numër të vogël të inspektorëve dhe kapaciteteve logjistike.

IP ka gjithsej 49 inspektorë të ndarë sipas qendrave regjionale, ku 18 janë në Prishtinë, 7 në Gjiilan, 7 në Pejë, 6 në Ferizaj, 4 në Prizren, 4 në Mitrovicë dhe 3 në Gjakovë. Numri prej 49 inspektorësh në 2017 është më i ulët se ai i vitit 2011 kur ishin 51 inspektorë.<sup>58</sup> Përveç kësaj, edhe kapacitetet logjistike janë të kufizuara. Inspektorati ka në dispozicion vetëm 12 automjete, dy më shumë se sa në vitin 2011. Në vitin 2016, IP ka ndërmarrë 7285 inspektime, ku ka shqiptuar 128 gjoba, kurse në 855 raste është dhënë vetëm vërejtje. Kurse deri në tetor të 2017 janë kryer 6656 inspektime, ku janë shqiptuar 180 gjoba dhe 944 vërejtje.

Ende nuk është futur në funksion Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Inspektoratin e Punës. Ky sistem, i mbështetur nga Bashkimi Evropian, ka për qëllim automatizimin e punës së inspektorëve përmes përdorimit të tabletave, lejon shkëmbimin më të lehtë dhe më të shpejtë të informatave me ATK dhe Trustin si dhe lejon monitorimin e punës së inspektorëve në terren.

Pjesa më e madhe e punonjësve nuk kanë sigurim shëndetësor, përveç atyre që kanë bërë një gjë të tillë vullnetarisht përmes agjencive të sigurimeve. Ligji për Sigurimin Shëndetësor<sup>59</sup>, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2015, ende nuk ka filluar të zbatohet. Sipas Udhëzimit administrativ për mbledhjen e premiumeve<sup>60</sup>, çdo i/e punësuar është i/e obliguar që të ndaj 3.5% të pagës së tij/saj për sigurime shëndetësore, kurse punëdhënësi e plotëson këtë shumë me 3.5% të nivelit të pagës së punëtorit/es. Në fund të 2016 është marrë vendimi që mbledhja e premiumeve të fillojë nga 1 janari 2017, për tu shtyrë për 1 korrik 2017, por që nuk pritet të fillojë para gjysmës së dytë të vitit 2018.

56 ASK. Anketa e Fuqisë Punëtore 2016. Burimi: <http://bit.ly/2AYaKKi>

57 Asistenca Teknike e BE për Kosovë. Vlerësim mbi shtrirjen e ekonomisë jo formale në Kosovë. Nëntor 2017.

58 Instituti GAP. Ligji i punës: gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi. Qershor 2011. Burimi: <http://bit.ly/29UMsm1>

59 Gazeta Zyrtare. Ligji nr.04/L-249 për sigurimin shëndetësor. Burimi: <http://bit.ly/1MhAePq>

60 Gazeta Zyrtare. Udhëzimi administrative nr.07/2016 për mbledhjen e premiumeve për sigurimin shëndetësor të obligueshëm: Burimi: <http://bit.ly/2zzBU5S>



## 5. Mirëqenia sociale

Të dhënat më të fundit për nivelin e varfërisë në konsum, tregojnë një ulje të varfërisë më 2015 në krahasim me vitet e mëhershme. Niveli i varfërisë më 2015, i atyre që jetojnë me më pak se 1.82 euro në ditë ishte 17.6%, gjersa varfëria ekstreme, atyre që jetojnë me më pak se 1.30 euro në ditë, ishte 5.2%.<sup>61</sup> Kjo është një rënie përgjyrmë në krahasim me vitin 2009, kur varfëria ishte 34.5%, kurse varfëria ekstreme 10.2%.<sup>62</sup>

Përderisa pas luftës matjet e Bankës Botërore tregonin varfëri më të madhe në zonat urbane se sa në ato rurale<sup>63</sup>, tani varfëria më e madhe është në zonat rurale. Ekonomitë familjare me më shumë se pesë anëtarë dhe ato që udhëhiqen nga gratë kanë tendencë të jenë më të varfra. Varfëria është më e madhe tek gratë dhe tek personat pa shkollim formal apo me vite më të pakta shkollimi. Sa i përket të ardhurave, qytetarët të cilët varen nga ndihma sociale, pensionet dhe puna me mëditje kanë tendencë më të lartë që të jetojnë në varfëri, në krahasim me ato familje të cilat varen nga pagat në sektorin publik apo remitencat. Pabarazia e qytetarëve më 2015 ka shënuar rënie në krahasim me vitin 2014 dhe është në 23.2%.<sup>64</sup>

Përveç në konsum, varfëria ka ndikim të madh edhe në pjesëmarrjen e fëmijëve nga familjet e varfra në procesin e arsimimit, duke mbajtur familjet në kurthin e varfërisë për periudha të gjata kohore. Rënia e nivelit të pjesëmarrjes në edukim bie me kalimin e viteve të shkollimit. Në këtë aspekt janë të prekur sidomos fëmijët e komuniteteve pakicë (romë, ashkali dhe egjiptian).

Kosova nuk ka një plan qeveritarë për luftimin e varfërisë. Programet e asistencës sociale mbulojnë vetëm 1/3 e familjeve të varfra. Madje edhe ato familje që marrin asistencë sociale nuk arrijnë të kalojnë pragun e varfërisë. Nuk ka as një vlerësim zyrtar se sa do ti kushtonte shtetit të Kosovës eliminimi i varfërisë apo varfërisë ekstreme. Kur në vitin 2000 niveli i varfërisë ekstreme ishte 11.9%, Banka Botërore vlerësonte se një shpenzim qeveritar prej 34-45 milionë marka gjermane, i targetuar mirë, mund të eliminojë varfërinë ekstreme. Nëse përdorim të njëjtën logjikë të përlogaritjes edhe për nivelin e varfërisë ekstreme më 2015, atëherë nevojiten rreth 17-22 milionë euro, varësisht nga hendeuku i varfërisë, për të eliminuar varfërinë ekstreme.

Pjesa më e madhe e skemave sociale të cilat menaxhohen nga MPMS, nuk targetojnë varfërinë, por janë skema të bazuara në kategori.

### 5.1. Skemat sociale të varfërisë kundrejt Skemave sociale në bazë të kategorive

Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të shtetit shkon për mbrojtje sociale. Në vitin 2016, klasifikimi buxhetor për mbrojtje sociale përbënte 22.05% të të gjitha shpenzimeve buxhetore, apo 386 milionë euro. Në vitin 2017 kjo shifër ka kaluar 400 milionë euro. Po ashtu, edhe në krahasim me GDP, Kosova është një ndër shpenzuesit më të mëdhenj në skema sociale në krahasim me vendet e rajonit dhe vendet e Evropës. Sipas Bankës Botërore, mesatarja e shpenzimeve për skemat sociale në vendet e Evropës dhe Azisë Qendrore sillet në 1.8% të GDP.<sup>65</sup>

61 ASK. Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës 2012-2015. Prill 2017. Burimi: <http://bit.ly/2l38Uk0>

62 ASK. Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës 2011. Mars 2013. Burimi: <http://bit.ly/2l1rWDg>

63 World Bank. Kosovo Poverty Assessment. December 2001. Burimi: <http://bit.ly/2k8LutD>

64 ASK. Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës 2012-2015. Prill 2017. Burimi: <http://bit.ly/2l38Uk0>

65 World Bank. Social Safety nets in Western Balkans: Design, Implementation and Performance. 2011. Burimi: <http://bit.ly/2y9OcTs>


Nëse i llogarisim vetëm skemat sociale, duke përjashtuar shpenzimet për punë dhe punësim si dhe shpenzimet për shërbimet sociale, atëherë del se në vitin 2017 Kosova ka shpenzuar 382 milionë euro në skema sociale, apo 6.09% e GDP.<sup>66</sup> Por, shumica e skemave sociale në Kosovë janë skema sociale të bazuara në kategori dhe jo në gjendjen sociale të përfituesve. Skema e vetme sociale e bazuar në varfëri është skema e asistencës sociale, ku nëse llogarisim edhe shpenzimet për rrymë për rastet sociale, përbën vetëm 8.3% të buxhetit të destinuar për skema sociale, apo 0.51% të GDP. Asistenca sociale së bashku me kompensimet për të verbrit dhe pensionet e aftësisë së kufizuar përbëjnë vetëm 0.91% të GDP. Kjo është dukshëm nën mesataren e vendeve të Evropës.

Ndarjet më të mëdha buxhetore shkojnë për skemat e bazuara në kategori. Skemat e bazuara në kategori, siç janë pensionet e moshës, pensionet e TMK apo FSK, pensionet për kategoritë e dala nga lufta, janë skema nga të cilat përfitojnë individët apo familjet vetëm pse i takojnë asaj kategorie, pa marrë parasysh gjendjen e tyre sociale. Për shembull, një person i cili ka arritur moshën 65 vjeçare, automatikisht është i kualifikuar që të marrë pensionin e moshës, edhe nëse ai ka të kursyera miliona euro. Njësoj, një person i kualifikuar si veteran i luftës së UÇK, kualifikohet që të marrë pensionin e veteranit, pa marrë parasysh gjendjen e tij/saj sociale.

Siç mund të shihet nga Figura 16, pjesa më e madhe e buxhetit për skema sociale shpenzohet për pensionet bazike dhe pensionet kontributdhënëse (3.25% e GDP) dhe për skemat e kategorive të luftës apo të ish të burgosurve politik (1.93% e GDP). Skemat e sociale të bazuara në kategori do të rriten edhe më tej, me përfshirjen edhe të pensioneve për deputetët e viteve të '90 (300 mijë euro të planifikuara për 2018), kompensimet për viktimat e dhunës seksuale (1 milion euro të planifikuara për 2018), kompensimet për mësimdhënësit e viteve të '90, e tjera.

66 GDP për 2017 është llogaritur duke marrë GDP e 2016 dhe duke ia shtuar 4.4% rritje të parashikuar nga Banka Botërore për 2017. World Bank. Western Balkans Regular Economic Report No.12. Burimi: <http://bit.ly/2BIJotx>

**Figura 16.** Buxheti për skemat sociale si përqindje e GDP



Përveç që pjesa më e madhe e buxhetit shkon në skema sociale kategorike, politika sociale në Kosovë karakterizohet nga transferet e larta monetare dhe nga investime të ulëta sociale. Investimet sociale nënkuptojnë investime në njerëz, të cilat kanë të bëjnë me ngritjen e shkathhtësisë dhe mbështetjen aktive për të marrë pjesë në tregun e punës dhe në jetën shoqërore. Ato përfshijnë fusha si edukimi, kujdesi ndaj fëmijëve, kujdesi shëndetësor, rehabilitimi, trajnimet dhe ndihma në gjetjen e një vendi të punës.<sup>67</sup> Me qëllim të ngritjes së investimeve sociale, më 2012 BE ka krijuar Fondin Social Evropian.<sup>68</sup> Me një buxhet prej 10 miliardë euro në vit, Fondi Social Evropian mbështet iniciativat e shteteve dhe organizatave jo qeveritare qëllimi i të cilave është sigurimi i punësimit të qëndrueshëm, asistimi i personave me aftësi të veçanta që të sigurojnë një vend pune, financimi i programeve të aftësimin profesional, e tjera.

67 European Commission. Employment, Social Affairs & Inclusion. Burimi: <http://bit.ly/2j30WnF>  
68 European Commission. Towards Social Investment for Growth and Cohesion - including implementing the European Social Fund 2014-2020. February 2013.

Përderisa mbi 200 milionë euro në vit shpenzohen për pensionet bazë dhe kontributdhënese, institucionet qendrore nuk kanë programe aktive për të moshuarit, siç mund të jenë qendrat rekreative dhe socializuese. Kosova ka vetëm një shtëpi të të moshuarve në gjithë vendin, e cila përballet me kushte të rënda në mungesë të investimeve. Përgjatë këtyre viteve është investuar shumë pak në shërbimet sociale, dhe Qendrat për Punë Sociale (QPS) të shpërndara në komunitet e Kosovës përballen me mungesë të hapësirave, kuadro profesionale dhe buxhet për të trajtuar të gjitha rastet në nevojë. Gjithashtu, edhe pse ndahen afër 20 milionë euro për pensionet e aftësisë së kufizuar, institucionet shtetërore nuk ofrojnë ndihmë të mjaftueshme për rehabilitim të këtyre personave në nevojë dhe, aty ku është e mundur, punësimin e tyre. Në mungesë të investimeve sociale substanciale, transferet monetare nuk ndihmojnë në tejkalimin e gjendjes së papunësisë afatgjatë, varfërisë dhe nuk ofrojnë ndihmë praktike për personat me aftësi të kufizuara.

## 5.2. Ndihmat sociale

Ligji për skemën e ndihmës sociale<sup>69</sup> rregullon mbështetjen financiare të familjeve të rrezikuara në aspektin social. Ndihma sociale u jepet familjeve të cilat bien në njërin nga këto dy kategori: Kategoria I, ku të gjithë personat e familjes janë të varur dhe asnjëri nga anëtarët e familjes nuk është i punësuar; dhe Kategoria II, familjet që kanë një pëson të aftë për punë, por të papunësuar, dhe së paku një fëmijë nën moshën 5 vjeçare, ose familjet kujdestare të një fëmije jetim deri në moshën 15 vjeçare. Pjesa më e madhe e familjeve që marrin ndihmë sociale hyjnë në kategorinë e parë (65%), apo familje në varësi të plotë. Për tu përfshirë në skemën e ndihmës sociale, familjet duhet të aplikojnë çdo gjashtë muaj, dhe të plotësojnë kriteret teknike dhe financiare.

Përkundër rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe rritjes së inflacionit, kompensimi për familjet në ndihmë sociale ka mbetur thuajse i njëjtë. Përderisa më 2003 pagesat silleshin nga 35 deri 75 euro, varësisht nga numri i anëtarëve të familjes, më 2017 pagesat për familje sillen nga 50 deri 150 euro.

69 Gazeta Zyrtare. Ligji nr.2003/15 i skemës së ndihmës sociale në Kosovë. Burimi: <http://bit.ly/2vp1hYr>

**Tabela 8.** Shuma mujore e kompensimeve sipas numrit të anëtarëve të familjes 2003-2017


Nr. i anëtarëve për familje	2003-2007			2008-2014			2015-2017		
Familje me 1 anëtarë	35 €	40 €	50 €						
Familje me 2 anëtarë	50 €	55 €	68.75 €						
Familje me 3 anëtarë	55 €	60 €	75 €						
Familje me 4 anëtarë	60 €	65 €	81.25 €						
Familje me 5 anëtarë	65 €	70 €	87.50 €						
Familje me 6 anëtarë	70 €	75 €	93.75 €						
Familje me 7 anëtarë	75 €	80 €	100 €						

Burimi: ASK, Statistikat e Mirëqenies Sociale 2003-2016

Numri i familjeve dhe individëve në asistencë sociale ka rënë dukshëm në krahasim me vitin 2003. Në vitin 2003 ishin mesatarisht 50 mijë familje në SNS dhe mesatarisht 190 mijë individë.<sup>70</sup> Në pesë muajt e parë të vitit 2017 asistencë sociale kanë marrë mesatarisht 26,255 familje, me 107,777 anëtarë. Sipas kësaj, 10% e familjeve, apo 6% e popullsisë së Kosovës, marrin asistencë sociale. Shuma mesatare mujore e ndarë për SNS është 2.4 milionë euro. Numri më i madh i familjeve në SNS është nga Mitrovica e Jugut.

70 ASK, Statistikat e Mirëqenies Sociale 2003. Burimi: <http://bit.ly/2AJzWEO>


**Figura 17.** Numri i familjeve dhe anëtarëve të tyre në SNS sipas komunave



Burimi: MPMS 2017

Por nëse merret numri i anëtarëve të familjeve në SNS në krahasim me numrin e përgjithshëm të popullsisë në komuna, atëherë del se Novobërda dhe Shtërpca kanë numrin më të madh të popullsisë në SNS, kurse Ferizaj dhe Mamusha numrin më të ulët.


**Figura 18.** Numri i familjeve dhe anëtarëve të tyre në SNS sipas komunave



Burimi: Kalkuluar në bazë të të dhënave të MPMS dhe parashikimit të popullsisë nga ASK

Sa i përket numrit të anëtarëve të familjes, pjesa më e madhe e familjeve janë me dy deri gjashtë anëtarë. Por ka edhe familje me dymbëdhjetë anëtarë. Kurse sa i përket ndarjes gjinore të bartësve të ndihmave sociale, 32.1% janë gra dhe 67.9% burra. Instituti GAP ka gjetur dallime të vogla në mënyrën e shpenzimit të buxhetit nga gratë dhe burrat kryefamiljarë. Burrat kryefamiljarë kanë tendencë të shpenzojnë më pak në shëndetësi (8%) dhe ushqim të shëndetshëm (4.4%), kurse më shumë në duhan (7%).<sup>71</sup>

**Figura 19.** Familjet në SNS sipas numrit të anëtarëve




Burimi: MPMS 2017

71 Instituti GAP. Menaxhimi i buxhetit familjar: gratë dhe burrat. Tetor 2017. Burimi: <http://bit.ly/2zqGwi7>

Buxheti për skemat e ndihmës sociale krahas shpenzimeve buxhetore ka shkuar duke rënë nga viti në vit. Përderisa më 2004 buxheti për SNS përbënte 5.19% të shpenzimeve totale të Qeverisë, sipas planifikimeve buxhetore për 2018 kjo do të bie në 1.5% dhe do të vazhdojë rënien edhe në vitet 2019-2020.

**Figura 20.** Buxheti i SNS në relacion me shpenzimet totale të buxhetit të shtetit 2003-2020




Për shkak të kriterëve strikte, ndihmat sociale kanë një nivel të lartë të targetimit të familjeve në nevojë, çfarë e bën shumë të vështirë që nga skema të përfitojnë familjet të cilat nuk i plotësojnë kriteret për ndihma sociale. Por mbulueshmëria e SNS është shumë e vogël. Nëse bazohemi në të dhënat e varfërisë për vitin 2015, sipas të cilave 17.6% e popullsisë jeton në varfëri me më pak se 1.82 euro në ditë, apo shprehur në numra rreth 317 mijë persona, del se skema e ndihmës sociale mbulon vetëm rreth 34% të popullsisë së varfër.

Por edhe ata që përfitojnë nga SNS nuk marrin kompensim të mjaftueshëm për të dalë nga kufiri i varfërisë. Mbi 70% e familjeve që varen nga ndihmat sociale të kategorisë së parë mbesin në varfëri.<sup>72</sup> Një familje mesatare pesë anëtarëshe në Kosovë i nevojiten minimum 273 euro në muaj për shpenzime bazike për të qëndruar jashtë varfërisë, kurse SNS mbulon vetëm 32% të këtyre shpenzimeve (87.5 €). Me rritjen e numrit të anëtarëve të familjes, mbulueshmëria bie.

72 ASK. Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës 2011-2015. Prill 2017. Burimi: <http://bit.ly/2i38Uk0>

**Figura 21.** Mbulueshmëria e SNS kundrejt kufirit të varfërisë



Kriteret për kualifikim për asistencë sociale nuk janë mjaft të argumentuara. FMN potencon së paku tri probleme të mëdha me kriteret teknike dhe financiare për të klasifikuar ose jo një familje në asistencë sociale:

- ✓ E para, familjet në kategorinë e dytë të SNS diskualifikohen nga skema në momentin kur fëmija ose fëmijët e tyre arrijnë moshën pesë vjeçare. Është e paqartë çfarë kriteri është përdorur kur është vendosur moshë pesë vjeçare e fëmijëve, kur merret parasysh se shpenzimet e familjeve për fëmijë nuk bien kur ai/ajo mbush pesë vjeç. Në anën tjetër, fëmijët janë më të rrezikuarit nga varfëria.
- ✓ Punësimi i një anëtari të familjes i largon familjet e kategorisë së dytë nga skema. Kjo shtyn shumë individë që të punojnë në sektor jo formal.
- ✓ Familjet që kanë pasuri të paluajtshme mbi 0.5 hektarë, diskualifikohen nga skema, edhe në rastet kur nuk arrijnë të gjenerojnë të ardhura nga ajo pasuri.<sup>73</sup>

Ministria e Financave ka paralajmëruar një rritje prej 20% të kategoritë që mbulohen nga SNS.<sup>74</sup> Me ndryshimet e paralajmëruara, nga viti i ardhshëm pagesat sipas madhësisë së familjeve do të duhej të dukeshin si në tabelën në vijim.

<sup>73</sup> IMF, Enhancing Social protection cash benefits. IMF country report no.16/123. May 2016.  
<sup>74</sup> KosovaPress. Intervistë me Bedri Hamza - Ministër i Financave. 12 nëntor 2017. Burimi: <http://bit.ly/2BITiel>


**Tabela 9.** Kompensimet mujore për familjet në SNS me rritjen e paralajmëruar prej 20%

Nr. i anëtarëve për familje	Kompensim (€)
Familje me 1 anëtarë	60 €
Familje me 2 anëtarë	82.5 €
Familje me 3 anëtarë	90 €
Familje me 4 anëtarë	97.5 €
Familje me 5 anëtarë	105 €
Familje me 6 anëtarë	112.5 €
Familje me 7 anëtarë	120 €
Familje me 8 anëtarë	127.5 €
Familje me 9 anëtarë	135 €
Familje me 10 anëtarë	142.5 €
Familje me 11 anëtarë	150 €
Familje me 12 anëtarë	157.5 €

2018

Por as kjo rritje nuk do të jetë e mjaftueshme për të nxjerrë nga varfëria familjet në asistencë sociale, siç e pasqyron grafikoni në vijim, i cili përmban rritjen prej 20% dhe kufirin e varfërisë të 2015 prej 1.82 euro në ditë.

**Figura 22.** Mbulueshmëria e SNS kundrejt kufirit të varfërisë pas rritjes së paralajmëruar prej 20%



### 5.3. Pensionet e veteranëve të luftës së UÇK


Procesi i verifikimit të listave të veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK ka filluar qysh në prill të vitit 2010. Qeveria<sup>75</sup> kërkonte që procesi i verifikimit të përmbyllet brenda vitit, por, nuk ishte bërë asnjë hap deri në tetor 2012, kur Qeveria kishte aprovuar Rregulloren e Punës së Komisionit<sup>76</sup>. Kjo rregullore parasheh funksionimin e Komisionit dhe procedurat e aplikimit për të marrë njërën nga statuset e pjesëmarrjes në luftën e UÇK. Po në tetor 2012 është themeluar edhe Sekretaria e Komisionit<sup>77</sup>, e cila shërben si mbështetje teknike e komisionit dhe pranon aplikacionet e veteranëve.

Për punën e Sekretarisë së Komisionit për verifikimin e listave të veteranëve të UÇK, nga viti 2012 deri më 2016, me pesë vendime të ndryshme, Qeveria ka ndarë 314,946 euro. Pas më shumë se pesë vite punë dhe pas mbi 300 mijë euro shpenzime, në qershor 2016 Qeveria aprovoi<sup>78</sup> raportin e punës së Komisionit, por listat ishin ende të papërfunduara. Lista përfundimtare mbetej që të aprovohet në të ardhmen. Me qëllim të të përmbylles së listave, Qeveria vazhdoi mandatin e Komisionit edhe për dy herë<sup>79</sup>. Më 27 tetor 2017, Qeveria Haradinaj sërish aprovoi një raport të papërfunduar të listës së veteranëve të UÇK.<sup>80</sup>

75 Zyra e Kryeministrit. Vendimi nr.04/121 i datës 22 prill 2010. Burimi: <http://bit.ly/2A2P8Zk>  
 76 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Rregullore nr.23/2012 për komisionin qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit, veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Burimi: <http://bit.ly/2yhGNnF>  
 77 Zyra e Kryeministrit. Vendimi nr.09/97 i datës 24 tetor 2010. Burimi: <http://bit.ly/2z0ItPv>  
 78 Zyra e Kryeministrit. Vendimi nr.05/90 i datës 1 qershor 2016. Burimi: <http://bit.ly/2hfWb17>  
 79 Fillimisht, me vendimin 05/118 të datës 30 nëntor 2016, Qeveria obligoi Komisionin që ta përfundojë punën deri më 23 dhjetor 2016. Pas kësaj, u mor vendimi nr.03/124 i datës 29 dhjetor, ku i kërkohet Komisionit që të përfundojë punën deri më 20 janar 2017.  
 80 Zyra e Kryeministrit. Vendimi nr.11/50 i datës 27 tetor 2017. Burimi: <http://bit.ly/2h0YC2T>

Ligji për veteranët e luftës së UÇK<sup>81</sup> u aprovua në prill të 2014. Ligji kategorizon veteranët në gjashtë kategori të ndryshme: veteran invalid, veteran luftëtar, veteran i internuar, veteran ushtar i pagjetur, veteran pjesëtar dhe veteran pjesëmarrës. Edhe pse ligji parasheh listat përfundimtare të veteranëve për secilën kategori, ai nuk parasheh afat kohor se kur duhet të përmbyllet ky proces. Sipas Ligjit, secili veteran luftëtar i cili verifikohet nga Komisioni dhe i cili nuk është duke punuar, ka të drejtë në pension të veteranit. Shuma e pensionit caktohet çdo vit, por nuk mund të jetë më e vogël se sa paga minimale.

**Figura 23.** Kronologjia e verifikimit të veteranëve të luftës



81 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Burimi: <http://bit.ly/1STtCcv>



Konform kësaj, në shtator 2015, përmes një vendimi ekzekutiv<sup>82</sup>, Qeveria përcaktoi shumën e pensioneve, duke u bazuar në pagën minimale, sipas të cilit veteranët luftëtarë të UÇK deri në moshën 35 vjeçare do të kompensohen me 130 euro në muaj, kurse veteranët mbi moshën 35 vjeçare do të kompensohen me 170 euro në muaj.

Por, duke parë se kompensimet për veteran mund të kalojnë mbi 1% të GDP të Kosovës, FMN kërkoi nga institucionet e Kosovës që të amendamentojnë ligjin. Kësisoj, Kuvendi aprovoi ndryshimet në dhjetor 2016. Me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veteranët<sup>83</sup> në dhjetor të 2016, u bë edhe një nën-kategorizim i veteranëve luftëtarë dhe u vendosën në ligj shumat e kompensimeve. Sipas këtyre ndryshimeve, veteranët luftëtarë ndahen në tri nënkategori:

- ✓ **Kategoria e parë:** Veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar nga viti 1991 deri më 5 mars 1998 dhe ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës.
- ✓ **Kategoria e dytë:** Veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar në luftë pas datës 5 mars 1998 dhe ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës.
- ✓ **Kategoria e tretë:** Veterani luftëtar i UÇK-së, i mobilizuar në luftë pas datës 31 mars 1999 dhe ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës, si dhe Veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar në luftë nga viti 1991, përkatësisht pas 5 mars 1998, por që nuk ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës.

Në bazë të këtyre kategorizimeve, kategoria e parë do të marrë pension prej 250 euro në muaj, kategoria e dytë 170 euro dhe kategoria e tretë 120 euro. Kjo formë e kompensimit do të fillojë aplikimin vetëm pas kategorizimit përfundimtar. Deri atëherë veteranët do të kompensohen sipas ligjit bazik, sipas pagës minimale në Kosovë.

Në ligjin bazik thuhej se veteranët të cilët janë në marrëdhënie pune në sektorin publik dhe privat, nuk kanë të drejtë të marrjes së pensionit. Kurse me plotësimin e ligjit thuhet se veteranët të cilët nuk paguhen nga buxheti i shtetit ose nga ndërmarrjet publike, kanë të drejtë të marrjes së pensionit deri në 50% të shumës. Gjithashtu, me ndryshimin e ligjit, vendoset edhe kufiri maksimal i kompensimeve sipas GDP, sipas të cilit pensionet nuk mund të kalojnë 0.7% të GDP.


### 5.3.1. Buxheti për pensionet e veteranëve

Për herë të parë pensionet e veteranëve ishin buxhetuar me Ligjin për Buxhetin e vitit 2015, ku ishte paraparë një kontigjencë prej 24 milionë eurosh. Por, veteranët filluan të marrin pensionet nga viti 2016. Me Ligjin për Buxhetin 2016 ishin buxhetuar 25 milionë euro për pensionet e veteranëve, shumë e cila u rrit edhe për 7 milionë euro me rishikimin e buxhetit. Në Ligjin për Buxhetin 2017 u buxhetuan 38 milionë euro dhe u tha se ky do të jetë kufiri maksimal, por me rishikimin e buxhetit kjo shumë u rrit për 69% dhe arriti në mbi 64 milionë euro. Projektbuxheti për vitin 2018, i cili u aprovua në fund të tetorit, parasheh shpenzime prej afër 59 milionë euro për vitin 2018, kurse për vitet 2019-2020 parashihet që kjo shumë të stabilizohet në 63,5 milionë euro.

82 Zyra e Kryeministrit. Vendimi nr.11/50 i datës 23 shtator 2015. Burimi: <http://bit.ly/2gYJMtZ>

83 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.05/L-141 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Burimi: <http://bit.ly/2gTUvBH>


**Figura 24.** Buxheti për pensionet e veteranëve



Në fillim të vitit 2017, pensionin e veteranit e kanë tërhequr 29,510 veteranë, prej tyre 2,199 ishin gra. Në muajin shtator ky numër ka mbërritur në 35,350 veteranë, prej tyre 3,476 gra.

Përfituesi më i ri në moshë i pensionit të veteranit është 20 vjeç, kurse përfituesi më i moshuar është 93 vjeç, i lindur më 1924. Por, 75% e përfituesve të pensionit të veteranit kanë lindur mes viteve 1961 dhe 1980. Duke marrë parasysh se sipas Ligjit, pensionin e veteranit mund ta tërheqin edhe trashëgimtarët, nuk dihet me saktësi se sa nga përfituesit janë trashëgimtarë të veteranëve. Me Ligjin për veteranët e UÇK ishte vendosur që trashëgimtarët të marrin deri në 70% të pensionit të veteranit, kurse me ndryshimin e Ligjit kjo shumë është përcaktuar në 250 euro, ekuivalent me kategorinë e parë të veteranëve përfitues.

**Figura 25.** Veteranët sipas grupmoshave






### 5.3.2. Manipulimet me lista të veteranëve dhe sfidat buxhetore

Edhe më tej, listat e veteranëve të luftës së UÇK nuk janë përmbyllur dhe nuk dihet sa do të jetë numri përfundimtar i tyre. Deri më tani për statusin e veteranit kanë aplikuar rreth 66,300 persona. Kurse certifikata të veteranit janë lëshuar për rreth 46,230 personave. Me përfundimin e luftës, sipas të dhënave të Organizatës Ndërkombëtare për Migrim, numri i luftëtarëve të UÇK të cilët u çarmatosën në shtator 1999 ishte 24,577 luftëtarë.<sup>84</sup>

Sipas Ligjit, buxheti total për pensionet e veteranëve nuk mund të kalojë 0.7% të GDP-së brenda një viti. Por ky rregull është shkelur që në vitin e parë, pasi që parashikimet e Qeverisë me Ligjin për buxhetin 2017 u tejkaluan dhe buxheti total për pensionet e veteranëve u rrit në 64 milionë euro. Nëse e marrim për bazë GDP e Kosovës për vitin 2016, e cila sillet rreth 6 miliardë euro, buxheti total për pensionet e veteranëve nuk do të duhej të kalonte asesi shumë prej 42 milionë eurosh. Kështu, buxheti për veteranët e UÇK ka kaluar mbi 1% të GDP.

**Figura 26.** Pensionet e veteranëve në krahasim me GDP

**Kufiri: 0.7% GDP** **Shpenzimi për pensionet e veteranëve**



Këto tejkalime janë në kundërshtim me marrëveshjen “stand-by” në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, e cila parashihte mos tejkalim të buxhetit për veteranët e UÇK mbi 0.7% të GDP.<sup>85</sup>

84 Anna di Lellio & Gerantina Kraja. Kush dhe si po i numëron ushtarët e UÇK-së? Sbuker.net, 6 shtator 2016. Burimi: <http://bit.ly/2ISGXfj>

85 IMF. Republic of Kosovo, Second and third reviews under stand-by arrangement. March 2017. Source: <http://bit.ly/2zw46tU>

Për shkak se Ligji për veteranët nuk parasheh kufizim moshe për përfituesit, mund të ndodhë që mbi 11 mijë veteranë të marrin pension vazhdimisht për një periudhë prej tri dekadash, nëse bazohemi në kriterin e jetëgjatësisë në Kosovë, e cila sipas ASK është 71 vjeç. Nëse marrim për bazë moshën e të gjithë përfituesve dhe shumë mesatare të pensionit prej 170 euro në muaj për tri vitet e para (2018-2020) dhe 210 euro për vitet në vazhdim, në 30 vitet e ardhshme do të shpenzohen përafërsisht rreth 2.5 miliardë euro.

**Tabela 10.** Projeksionet e pensioneve të veteranëve 2018-2047

Numri i veteranëve	Pensioni i veteranit (€)	Vite	Kosto mesatare deri më 2047 në €	Kosto mesatare deri më 2047 në € me inflacion
113	170	1	230.520	286.623
155	170	2	632.400	786.310
179	170	3	1.095.480	1.362.092
210	180	4	1.814.400	2.255.978
264	186	5	2.946.240	3.663.279
240	190	6	3.283.200	4.082.247
301	192	7	4.854.528	6.035.995
342	195	8	6.402.240	7.960.381
419	196	9	8.869.392	11.027.974
438	198	10	10.406.880	12.939.647
527	199	11	13.843.236	17.212.324
543	200	12	15.638.400	19.444.385
603	200	13	18.813.600	23.392.347
612	201	14	20.666.016	25.695.593
739	202	15	26.870.040	33.409.517
773	202	16	29.980.032	37.276.402
810	203	17	33.543.720	41.707.400
866	203	18	37.972.368	47.213.867
877	204	19	40.691.046	50.594.201
998	204	20	48.862.080	60.753.855
965	204	21	49.608.720	61.682.208
1.058	205	22	57.119.304	71.020.675
1.124	205	23	63.533.875	78.996.388
1.213	205	24	71.615.520	89.044.898
1.237	205	25	76.075.500	94.590.322
1.333	205	26	85.258.680	106.008.452
1.426	206	27	94.945.932	130.966.562
1.524	206	28	105.331.565	130.966.562
1.622	206	29	116.165.045	144.436.632
1.863	206	30	138.160.080	171.784.694
11.236	205	31	856.857.360	1,065.394.427
			<b>2,042,087,399</b>	<b>2,539,079,007</b>

Se listat e veteranëve janë të fryra, këtë e kanë pranuar thuajse të gjithë liderët shtetërorë. Madje edhe vetë Kryesuesi i Komisionit për verifikimin e veteranëve të UÇK e pranon se listat janë të fryra.

Në Raportin e Auditimit për vitin 2016, Zyra Kombëtare e Auditimit kishte gjetur se në 1,275 raste MPMS kishte ndarë pension edhe për veteranët që janë në marrëdhënie pune. Vetëm për këtë buxheti i shtetit është dëmtuar për 215,488 euro.<sup>86</sup> Këto lëshime kanë ndodhur përkundër asaj se për çdo muaj, para se të bëhen pagesat e pensioneve, duhet të bëhet verifikimi edhe me ATK dhe Trustin, për tu siguruar se përfituesit nuk janë në marrëdhënie pune. Sipas informatave jo zyrtare, procesi i verifikimit të veteranëve është duke u hetuar nga Prokuroria.

Përveç kësaj, Auditori kishte gjetur se në 946 raste veteranët përfitojnë nga dy skema pensionale. Në rastet më të shpeshta, veteranët përfitojnë edhe nga skema e ndihmës sociale dhe pensionin e veteranit.

**Tabela 11.** Veteranët përfitues në më shumë se një skemë pensionale

Skema pensionale	Numri i pagesave	Dëmi financiar (€)
Veteran përfitues edhe në skemën e pensioneve bazë	42	3,375
Veteran përfitues edhe në skemën e pensioneve kontributive	33	5,508
Veteran përfitues në skemën e PPAK-së	28	2,850
Veteran përfitues në skemën e TMK-së	8	1,360
Veteran përfitues në skemën e Trepçës	1	105
Veteran përfitues në skemën e Ndhimave Sociale	834	84,130
<b>Total</b>	<b>946</b>	<b>97,328 €</b>

Burimi: Raporti i Auditorit për MPMS 2016

Ligji për veteranët e luftës së UÇK nuk merr për bazë gjendjen sociale të veteranëve. Për dallim nga skemat e ndihmës sociale, në të cilat ndiqet një procedurë më rigorozë se kush mund të përfshihet në skemë, pensionin e veteranit e marrin të gjithë ata që pajisen me certifikatë të veteranit dhe të cilët nuk janë në marrëdhënie të punës në sektorin publik. Pensioni i veteranit nuk është i kufizuar as në moshë. Sipas FMN, kjo i motivon të punësuarit që të lënë punën, të kërkojnë një vend pune, apo të punojnë në ekonomi joformale, ku nuk deklarohen tatimet në ATK apo pensionet në Trust.<sup>87</sup>

86 Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti i Auditimit për raportin financiar vjetor të MPMS për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016. Burimi: <http://bit.ly/2y6tthM>.

87 IMF. Republic of Kosovo, Second and third reviews under stand-by arrangement. March 2017. Source: <http://bit.ly/2zw46tU>

Dy vende tjera të cilat shpenzojnë shuma të mëdha nga buxheti i shtetit për pensionet e veteranëve të luftës janë edhe Bosnja dhe Kroacia. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, këto dy vende shpenzojnë deri në 2% të GDP për pensionet e kategorive të luftës, duke përfshirë edhe invalidët e luftës, familjet e veteranëve, etj.<sup>88</sup> Lista përfundimtare e veteranëve të luftës në Kroaci përmban rreth 500,000 emra.<sup>89</sup>

Ligji për veteranët e UÇK është në masë të madhe i adaptuar sipas modelit kroat për kompensimin e veteranëve të luftës. Ky sistem bazohet kryesisht në 'kompensimet pasive', apo ofrim të asistencës financiare, se sa masa aktive për fuqizimin ekonomik dhe social të ish pjesëtarëve të luftës.<sup>90</sup>

Shpenzimi i shumave të mëdha të parave në skemat pensionale të veteranëve është një formë tjetër e klientelizmit, apo edhe "kapjes së skemave sociale". Ndryshimi i skemës së pensioneve të veteranëve do të jetë tepër i vështirë edhe për shkak të kundërshtimit të ashpër nga shoqatat e dala nga lufta. Por, deri më tani nuk ka pasur as përpjekje serioze nga partitë politike, pozite apo opozitë, që të propozojnë forma jo financiare të asistencës për veteranët e UÇK.

## 5.4. Pensionet e viktimave të torturës dhe dhunës seksuale

Në vitin 2014, Kuvendi i Kosovës ndryshoi Ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmoreve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK, viktimave civile dhe familjeve të tyre, duke përfshirë në ligj edhe viktimat e dhunës seksuale të luftës.<sup>91</sup> Viktimat e dhunës seksuale të luftës konsiderohen personat të cilët i kanë mbijetuar torturës dhe dhunës seksuale brenda periudhës 27 shkurt 1998 deri 20 qershor 1999. Konsiderohet se janë rreth 20 mijë viktimat të dhunës seksuale të luftës, por numri i saktë nuk dihet. Viktimat e dhunës seksuale të luftës do të përfitojnë të gjitha të drejtat e parapara me ligj të cilat i kanë përfituar deri më tani viktimat civile, familjet e dëshmoreve, invalidët, veteranët.

Përfshirja e viktimave të dhunës seksuale në ligj është përcjellë me kundërshti të shumta nga përfaqësuesit e shoqatave të veteranëve të luftës dhe nga disa deputetë të Kuvendit të Kosovës.<sup>92</sup> Disa refuzonin t'iu atribuonin legjitimitetin e të dëmtuarave të luftës këtyre viktimave, disa mendonin se përkrahja financiare për këtë kategori do të jetë humbje e madhe për buxhetin, e kishte edhe të tillë që propozuan ekzaminime mjekësore për vërtetësi të rrëfimeve të këtyre grave. Kjo kategori e luftës vazhdoi të jetë një ndër kategoritë më të pambrojtura, të neglizhuara dhe të turpëruara nga institucionet dhe shoqëria.

Përkundër asaj se ligji parashihte që brenda gjashtë muajve nga hyrja e tij në fuqi të nxirren aktet nënligjore dhe të themelohet Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e viktimave të dhunës seksuale, Qeveria nuk respektoi këto afate. Rregullorja për përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit të viktimës së dhunës seksuale u aprovua gati dy vite më vonë, në shkurt të vitit 2016.<sup>93</sup> Komisioni qeveritar për verifikim në përbërje prej nëntë anëtarësh u themelua në prill të vitit 2017<sup>94</sup>, kurse sekretaria e komisionit në përbërje prej tre anëtarësh u themelua në nëntor 2017<sup>95</sup>.

88 World Bank. Social safety nets in the Western Balkans: design, implementation, and performance. Burimi: <http://bit.ly/2y90cTs>.

89 Paul Stubbs & Sinisa Zrinscak. Citizenship and Social Welfare in Croatia: Clientelism and the limits of 'Europeanisation'. European Politics and Society, 2015. Vol.16, No.3. Page 395-410.

90 Paul Stubbs & Sinisa Zrinscak. Citizenship and Social Welfare in Croatia: Clientelism and the limits of 'Europeanisation'. European Politics and Society, 2015. Vol.16, No.3. Page 395-410.

91 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-054. Burimi: <http://bit.ly/2zOWWSa>

92 [https://www.youtube.com/watch?v=hzBUYG8hQ\\_s](https://www.youtube.com/watch?v=hzBUYG8hQ_s)

93 Gazeta Zyrtare. Rregullorja nr.22/2015 për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare të Kosovës. Burimi: <http://bit.ly/2zOWWSa>

94 Zyra e Kryeministrit. Vendimi nr.06/143, i datës 28 prill 2017. Burimi: <http://bit.ly/2zQp14L>

95 Zyra e Kryeministrit. Vendimi nr.05/14, i datës 15 nëntor 2017. Burimi: <http://bit.ly/2zPcsxz>

Rregullorja përcakton procedurat për aplikim dhe formularin që duhet plotësuar. Sipas Rregullores, Komisioni shqyrton formularët e dorëzuar nga viktimat e dhunës seksuale, pa pasur nevojë që viktimat të paraqiten fizikisht. Në raste të caktuara, nëse Komisioni e vlerëson të nevojshme, mund të kërkohet edhe prania fizike e viktimës. Për shkak të ndjeshmërisë së rasteve, në rastet kur kërkohet prania fizike e viktimave, do të marrin pjesë vetëm tre nga anëtarët e komisionit. Përkundër asaj se hartuesit e Rregullores janë munduar që të mbrojnë identitetin e viktimave dhe t'i kursejnë nga prezenca fizike gjatë procesit të verifikimit, pas marrjes së pensionit personal viktimat obligohen që të paraqiten çdo gjashtë muaj në zyrat regjionale të Departamentit përkatës për Familjet e Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës (DFDIL). Duke marrë parasysh funksionimin e DFDIL ku hapësirat e punës të cilat nuk garantojnë privatësi për viktimat, obligimi për tu paraqitur çdo gjashtë muaj mund të paraqes presion shtesë psikologjik ndaj viktimave të dhunës seksuale.

Procesi i verifikimit do të zgjasë pesë vite, nga dita e themelimit të komisionit dhe pritet të përfundojë në vitin 2022. Me Projektbuxhetin për vitin 2018 janë buxhetuar një milion euro për pensionet e viktimave të dhunës seksuale. Kurse në nëntor të 2017, Qeveria përcaktoi edhe shumën e pensionit prej 230 euro. Bazuar në ndarjet buxhetore, Qeveria nuk pret që numri i viktimave të dhunës seksuale që do të marrin pension të kaloj 350 persona. Deri në fund të muajit nëntor 2017 nuk ka pasur asnjë aplikim, por Komisioni pret që në fillim të vitit 2018 të aplikojnë deri në një mijë persona.<sup>96</sup> Nëse vetëm gjysma e viktimave të dhunës seksuale aplikojnë për pension, buxheti vjetor për këtë kategori do të sillet rreth 28 milionë euro.

## 5.5. Shërbimet sociale

Shërbimet sociale rregullohen me Ligjin për shërbimet sociale dhe familjare<sup>97</sup>. Shërbimet sociale ofrohen nga Qendrat për Punë Sociale (QPS) të cilat janë themeluar dhe menaxhohen nga komunat. Kurse në nivel qendror përgjegjës është Divizioni për Shërbime Sociale në kuadër të Departamentit të Mirëqenies Sociale në MPMS. QPS ofrojnë shërbime të cilat kanë për qëllim mbështetjen e personave dhe familjeve në nevojë, siç mund të jenë fëmijët me sjellje asociale, fëmijët pa përkujdes prindëror, delikuentet e mitur, kujdes për personat në moshë të cilët nuk kanë përkujdesje familjare, trajtimi i rasteve të dhunës në familje, viktimat e trafikimit, etj.

Përveç institucionit për përkujdesje të të moshuarve dhe atij për shëndetin mendorë, nga janari i vitit 2009 të gjitha institucionet me bazë në komunitet kanë kaluar nën menaxhim të komunave. Me Ligjin për vetëqeverisje lokale, komunat kanë kompetenca vetanake sa i përket ofrimit të shërbimeve sociale. Mirëpo, për shkak të kufizimeve buxhetore, edhe më tej transferet financiare bëhen nga ana e MPMS. Me qëllim të ndarjes së grantit specifik për komuna për shërbimet sociale, ashtu sikurse për grantin për arsim dhe atë për shëndetësi, tani e disa vite është propozuar ndryshimi i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ku do të përfshihej edhe granti për shërbimet sociale. Edhe pse Qeveria e Kosovës ka marrë obligim me PKZMSA se ky ligj do të ndryshohet më 2016, një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur.

Po sipas PKZMSA, Qeveria ka marrë obligim edhe në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbimet sociale dhe familjare si dhe aprovimin e një ligji të ri për kujdesin ndaj të moshuarve, por as këto dy ligje nuk janë aprovuar dhe nuk pritet të aprovohen para vitit 2019.<sup>98</sup> Për disa nga shërbimet sociale, MPMS nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me organizatat jo qeveritare të cilat janë të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale. Deri më tani janë licencuar rreth 15 OJQ të tilla të cilat marrin përsipër përmbushjen e detyrave të caktuara nën misionin e MPMS. Por, nuk ekziston një grant specifik për financimin e ofruesve joqeveritarë të shërbimeve sociale, ashtu siç është premtuar edhe me PKZMSA.

96 Minire Begaj. Kryetare e Komisionit për verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale të luftës. Prononcim për Radi-on Evropa e Lirë, 25 nëntor 2017. Burimi: <http://bit.ly/2j1wsT7>

97 Gazeta Zyrtare. Ligji nr.02/L-17 për shërbimet sociale dhe familjare, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-81. Burimi: <http://bit.ly/2zzhVUW>

98 Intervistë me Bajram Kelmendi – Drejtor i Divizionit për Shërbimet Sociale, 27 nëntor 2017. Prishtinë.

**PENSIONET**

## 6. Pensions

Pas luftës, Kosova ka vendosur një sistem të ri pensional. Bazat e këtij sistemi u vendosën në fund të vitit 2001 me Rregulloren e UNMIK 2001/35 për pensionet.<sup>99</sup> Sistemi pensional në Kosovë përbëhet nga tri shtylla:


- ✓ Pensionet bazike të moshës, të cilat ju paguhen automatikisht të gjithë personave që arrijnë moshën 65 vjeçare, pa marrë parasysh statusin social dhe historikun e punësimit.
- ✓ Kontributet individuale të të punësuarve të cilat administrohen nga Fondi i Kursimeve Pensionale (Trusti). Çdo i punësuar duhet të ndajë 10% të rrogës (5% i punësuarit dhe 5% punëdhënësi). Kontributet pensionale investohen nga Trusti me qëllim të rritjes së vlerës dhe mund të tërhiqen me arrijtjen e moshës 65 vjeçare.
- ✓ Kontributet vullnetare pensionale, të cilat mund të bëhen nga të punësuarit mbi baza vullnetare në njërin nga fondet private pensionale të licencuara nga BQK.

Me ndryshime të vogla, skema pensionale e vendosur më 2001 vazhdon të aplikohet edhe tani. Departamenti i Pensioneve në kuadër të MPMS është përgjegjës për administrimin e pensioneve të paguara nga buxheti i shtetit.

Përveç pensioneve të moshës, aplikohen edhe skema tjera pensionale, si skema për ish-pjesëtarët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, pensionet e parakohshme të ish pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, pensionet e parakohshme të Trepçës, etj. Me aprovimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti<sup>100</sup> u unifikuan në një ligj disa nga skemat pensionale, duke përfshirë pensionet e moshës, pensionin kontributpagues të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionit familjar dhe invalidor të punës.

99 Gazeta Zyrtare e UNMIK. Rregullorja 2001/35 për pensionet në Kosovë. Dhjetor 2001. Burimi: <http://bit.ly/2Bx2Ggm>  
100 Gazeta Zyrtare. Ligji ne.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti. Burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9517>

**Figura 27.** Shpenzimet vjetore për kategori të ndryshme pensionale







Nga viti 2018 do të fillojë edhe ndarja e pensioneve familjare, pensioneve invalidore të punës dhe pensionet e deputetëve të viteve '90. Pensioni familjar dhe pensioni invalidor i punës janë të parapara me Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe sipas ligjit do të duhej të fillonin së zbatuari që nga 1 janari 2015. Por për shkak të kufizimeve buxhetore, deri më tani nuk kanë pasur mundësi realizohen. Pensioni familjar është pension i rregullt mujor i paguar për anëtarët e familjes në rast të vdekjes së të punësuarit që ka qenë në marrëdhënie pune. Kurse pensioni invalidor i punës është pensioni i rregullt mujor, i paguar për personat që pësojnë lëndime në punë apo fitojnë sëmundje profesionale gjatë marrëdhënies së punës. Më 2016 ishin 340,553 përfitues individual të skemave të ndryshme sociale.

**Figura 28.** Numri i përfituesve sipas skemave sociale

Pensioner të moshës	Individë në skema sociale	Pensioner kontribut-dhënës	Veteran i luftës	Persona me aftësi të kufizuar	Dëshmorë dhe invalid të luftës	Persona të verbër	Minatorët e Trepçës	Familjet me fëmijë me aftësi të kufizuar	Pensioner të TMK	Pensioner të FSK
120.017	107.575	41.315	28.207	19.833	12.680	3.627	3.412	2.737	932	218

Ende pa u mbushur dy vite nga hyrja në fuqi e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, MPMS kishte kërkuar aprovimin e një ligji të ri. Sipas Koncept dokumentit për rregullimin e fushës së pensioneve, ligji i ri do të duhej të përmbush këto objektiva:

-  Rishikimi i kriterëve për realizimin e të drejtave dhe përfitimeve në pension për të gjithë qytetarët mbi 65 vjeç që përfitojnë nga skemat aktuale të pensioneve;
-  Garantimin dhe sigurimin e pensioneve të cilat financohen nga buxheti i shtetit për të gjithë qytetarët të cilët janë banorë të përhershëm të Kosovës dhe shtetasve të huaj, të cilët nuk përfitojnë pensione dhe të hyra nga ndonjë skemë tjetër publike apo private, brenda dhe jashtë vendit;
-  Krijimi i mundësive për inicimin e negociatave dhe nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale për sigurime sociale në fushën e pensioneve me disa vende të BE;
-  Parandalimin e keqpërdorimit të pensioneve përmes krijimit të mekanizmeve mbikëqyrëse për ata pensionistë dhe familjarë të tyre që po realizojnë të hyrat në kundërshtim me bazën ligjore në fuqi.<sup>101</sup>

Përkundër asaj se ishte pjesë e programeve legislative të vitit 2016 dhe 2017, deri në dhjetor të 2017 Ligji për ndryshimin

dhe plotësimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti nuk është aprovuar ende në Qeveri.

101 Qeveria e Kosovës. Vendimi nr.02/81 për aprovimin e Koncept dokumentit për rregullimin e fushës së pensioneve, mars 2016. Burimi: <http://bit.ly/2A1RXIH>

## 6.1. Pensionet e moshës dhe kontributdhënëse

Për shkak të luftërave në ish-Jugosllavi, qytetarët e moshuar të Kosovës kishin humbur kursimet e tyre pensionale. Nga 107,000 persona në moshën mbi 65 vjeç, rreth 65,000 prej tyre merrnin pension nga kontributet e punës, i modeluar sipas modelit “pay as you go”.<sup>102</sup> Me qëllim të lehtësimit të barrës së pleqërisë, u vendos ndarja e pensioneve bazike të moshës për secilin person që ka mbushur 65 vjeç. Fillimisht kjo shumë u vendos në 28 euro për muaj, duke arritur në 75 euro nga viti 2014 e këndej.

Nga viti 2008, të moshuarit e moshës mbi 65 vjeç të cilët kanë kontribuar për së paku 15 vite në sistemin pensional ish-Jugosllav dhe që mund të dëshmojnë këtë me letra, marrin një pension shtesë prej 35 euro në muaj. Kurse nga viti 2016 filloi aplikimi i kriterëve për shkallën e pensioneve kontributdhënëse bazuar në nivelin e shkollimit.

**Tabela 12.** Numri i pensionistëve, shkalla mujore e pensionit dhe buxheti vjetorë për pensionet e moshës

Viti	Numri i pensionistëve dhe buxheti për kategoritë e pnesioneve të moshës dhe kontributdhënës							
	Total	Pensionist social	Pensionist kontribut-dhënës	Shkalla mujore e pensionit bazë (€)	Shkalla e pensionit kontribut-dhënës (€)	Buxheti vjetor për pensionet bazë (€)	Buxheti vjetor për pensionet kontribut. (€)	Total (€)
2002	93,087	93,087	-	28	-	31,277,232	-	31,277,232
2003	108,279	108,279	-	35	-	45,477,180	-	45,477,180
2004	116,932	116,932	-	40	-	56,127,360	-	56,127,360
2005	124,893	124,893	-	40	-	59,948,640	-	59,948,640
2006	127,356	127,356	-	40	-	61,130,880	-	61,130,880
2007	131,874	131,874	-	40	-	63,299,520	-	63,299,520
2008	166,621	138,847	27,774	40	75	66,646,560	24,996,600	91,643,160
2009	153,230	130,347	22,883	45	80	70,387,380	21,967,680	92,355,060
2010	140,226	109,585	30,641	45	80	59,175,900	29,415,360	88,591,260
2011	139,560	107,145	32,415	45	80	57,858,300	31,118,400	88,976,700
2012	147,765	113,043	34,722	50	101	67,825,800	42,083,064	109,908,864
2013	153,057	117,042	36,015	60	112	84,270,240	48,404,160	132,674,400
2014	164,534	125,883	38,651	75	140	113,294,700	64,933,680	178,228,380
2015	172,365	132,000	40,365	75	140	118,800,000	67,813,200	186,613,200
						158*		
						172**		
2016	161,332	120,017	41,315	75		108,015,300	84,540,406	192,555,706
						186***		
						230****		
2017						114,202,807	89,713,800	203,916,607
2018						116,276,788	89,891,647	206,168,435

158\* Arsimit fillor, 172\*\* I mesëm, 186\*\*\* I lartë, 230\*\*\*\* Universitar

102 Qeveria e Kosovës. Vendimi nr.02/81 për aprovimin e Koncept dokumentit për rregullimin e fushës së pensioneve, mars 2016. Burimi: <http://bit.ly/2A1RXIH>




Pensionet e moshës dhe ato kontributdhënëse përbëjnë 60% të buxhetit të destinuar për skemat sociale, ose 3.25% të GDP të vendit. Edhe pse ligji parasheh një indeksim të shkallës së pensionit varësisht nga lëvizja e çmimeve të konsumit, një indeksim i tillë automatik nuk ekziston, por bëhet në baza ad hoc në periudha të ndryshme.<sup>103</sup>

I njëjti person nuk mund të përfitoj nga të dy skemat njëherësh. Por pensionerët e moshës dhe ata kontributpagues mund të përfitojnë njëkohësisht nga skema tjera pensionale, si mund të jenë kursimet nga Trusti ose nga pensionet e jashtme. Kjo bën që pensionistët e moshës, të cilët nuk kanë se paku 15 vite përvojë pune në sistemin pensional të ish-Jugosllavisë, nuk kanë kursime të pasluftës, si dhe nuk marrin pensione të jashtme, përballen me një gjendje më të rënduar sociale. Pensioni i moshës prej 75 euro është i mjaftueshëm për të kaluar kufirin e varfërisë në konsum, por i pamjaftueshëm në rast se llogariten edhe shpenzimet mjekësore dhe shpenzimet e banimit, përfshirë faturat e shërbimeve (rryma, uji, ngrohja, mbeturinat). Shpenzimet e banimit përbëjnë 29% të të gjitha shpenzimeve vjetore të një familjeje, kurse shpenzimet mjekësore përbëjnë 3% të shpenzimeve.<sup>104</sup> Të moshuarit kanë tendencë të shpenzojnë më shumë për shëndetësi.<sup>105</sup> Me ndryshimet në pakon fiskale më 2015, TVSh në barna u rrit nga zero në 8%, çfarë ndikon në uljen e fuqisë blerëse tek të moshuarit.

Në anën tjetër, përkundër asaj se ligji e specifikon se përfituesit e pensioneve duhet të jenë banorë të përhershëm të Kosovës, sipas të dhënave zyrtare ka më shumë përfitues se sa popullsi në moshën mbi 65 vjeç. Në vitin 2016 ishin 161,332 përfitues të pensionit të moshës dhe atij kontributpagues, gjersa sipas llogaritjeve të ASK në vitin 2016 ishin 147,734 qytetarë mbi moshën 65 vjeçare<sup>106</sup>.

**Figura 29.** Popullsia mbi moshë 65 vjeç kundrejt përfituesve të pensioneve të moshës




103 IMF. Enhancing social protection cash benefits. Maj 2016. Burimi: <http://bit.ly/2nfgucB>  
 104 ASK. Rezultatet e anketës të buxhetit të ekonomive familjare 2016. Burimi: <http://bit.ly/2AI3ORq>  
 105 Instituti GAP. Menaxhimi buxhetit familjar: gratë dhe burrat. Tetor 2017. Burimi: <http://bit.ly/2zqGwi7>  
 106 ASK. Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2011-2016. Burimi: <http://bit.ly/2j3VuB9>

Sipas MPMS, kriteri për të qenë banor i përhershëm i Kosovës, nuk është duke u përfillur sa duhet nga një pjesë e madhe e qytetarëve të Kosovës të cilët jetojnë jashtë vendit e për të cilët, me ligjet e aplikueshme në Kosovë të jesh banorë i përhershëm i Kosovës lejon shumë hapësirë për keqpërdorime.<sup>107</sup>

Me Koncept dokumentin për rregullimin e fushës së pensioneve, MPMS arsyetonte ndryshimin e skemës pensionale të moshës, e cila nga kriteri i bazuar në moshë, do të kalonte në kriterin e bazuar në gjendjen sociale. Rrjedhimisht, jo të gjithë personat që arrijnë moshën 65 vjeç do të mund të marrin pension, në rast se ata kanë burime tjera të të ardhurave. Përveç kësaj, me ndryshime ligjore, siç u cek më sipër, MPMS kërkon ashpërsim të masave për pensionistët që nuk jetojnë në Kosovë dhe vazhdojnë të marrin pensionin e moshës.

Një arsye shtesë përse do të duhej të ndryshohej baza ligjore për pensionet e moshës është edhe barra gjithnjë e më e madhe buxhetore për shkak të rritjes së numrit të të moshuarve. Kosova është një ndër vendet me popullsinë më të re në Evropë dhe me natalitetin më të lartë, me 66% të popullsisë në moshë të punës dhe vetëm 10% e popullsisë mbi moshën 65 vjeç. Por nëse analizohen të dhënat e pesë viteve të fundit, shihet se ka një rritje të popullsisë mbi moshën 65 vjeç dhe një rënie të popullsisë nën 15 vjeç.

**Figura 30.** Ndryshimet në moshën e popullsisë 2012-2017




Burimi: ASK, Anketat e Fuqisë Punëtore 2012-2017

107 Qeveria e Kosovës. Vendimi nr.02/81 për aprovimin e Koncept dokumentit për rregullimin e fushës së pensioneve, mars 2016.

Nëse bazohemi në parashikimin e popullsisë për vitet 2011-2060, rënia e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe rritja e moshës mesatare të popullsisë do të rritet, si pasojë e rënies së natalitetit, rritjes së jetëgjatësisë dhe rritjes së emigrimit.

**Figura 31.** Ndryshimet në moshën e popullsisë 2012-2017



Burimi: ASK

Sipas Bankës Botërore, numri i personave në moshë të punës që mbështesin një pensionist do të bie nga 10 sa është sot në vetëm 4 më 2050.<sup>108</sup> Nëse bazohemi në numrin në rritje të pensionistëve dhe llogarisim buxhetin për pensione, me bazën aktuale prej të pensioneve prej 75 euro dhe llogarisim një rritje vjetore të pensionit prej 2%, atëherë deri më 2036, për shembull, vetëm për pensionet e moshës buxheti do jetë mbi 405 milionë euro.

<sup>108</sup> World Bank. Republic of Kosovo – Systematic Country Diagnostic. January 2017.

## 6.2. Kursimet pensionale

Shtylla e dytë e sistemit pensional rregullohet me Ligjin për fondet pensionale të Kosovës. Edhe pse shtylla e dytë sistemit pensional menaxhohet komplet ndaras nga buxheti i shtetit, kursimet pensionale kanë ndikim të madh në sistemin aktual të pensioneve të paguara nga buxheti i shtetit.

Çdo qytetarë i Kosovës në marrëdhënie pune është i detyruar që të paguaj 5% të pagës së tij si kursim në Fondin e Kursimeve Pensionale (Trusti), ku edhe punëdhënësi kontribuon me 5%. Punëdhënësi dhe punëmarrësi mundën vullnetarisht që këtë kontribut ta ngrisin deri në 10%. Për shtetasit e huaj që janë me punë në Kosovë nuk lejohen kursimet në Trust. Ky përjashtim nga kursimet e shtetasve të huaj mund të paraqet probleme me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve për sigurimet sociale me vendet tjera.<sup>109</sup>

Kursimet pensionale investohen në tregjet ndërkombëtare me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së vlerës, në krahasim me inflacionin. Në vitin 2016 kthimi nga investimet ishte 4.4%, tri herë më i lartë se Indeksi i Çmimeve të Konsumit prej 1.3%.<sup>110</sup> Në vitin 2016 ishin 312,672 kontribues aktiv, moshë mesatare e të cilëve ishte 40.7 vite. Për shkak të punësimit të paqëndrueshëm, jo të gjithë kontribuesit kontribuojnë aktivisht përgjatë tërë vitit ose për më shumë se një vit. Përderisa më 2016 kontribues nismëtarë ishin 32,055 persona, 36,922 të tjerë pauzuan, duke mos përfshirë këtu ata që kanë mbërritur moshën e pensionit. Për shkak të pagave të ulëta, kontributet pensionale nuk janë të mjaftueshme për të siguruar pensione të mjaftueshme për një periudhë të gjatë.

Në anën tjetër, një numër i madh i kontributpaguesve fillon të kontribuojnë në Trust pas moshës 40 vjeçare. Në vitin 2014, 13.9% e kontributpaguesve fillestarë ishin mbi moshën 40 vjeçare, në vitin 2015, 14% e kontribut paguesve nismëtar ishin mbi moshën 40 vjeçare, kurse më 2016 kjo u rrit në 14.6%. Në total për tri vite, 11,859 persona filluan kontributet pas moshës 40 vjeçare. Këta persona, edhe nëse do të mund të punojnë pandërprerë për 25 vite deri në moshën e pensionimit, me pagën mesatare aktuale në Kosovë, nuk do të kenë kursime të mjaftueshme. Sipas të dhënave të Trustit për vitin 2016, bilanci mesatar i kontributeve është 2,795 euro, kurse për kontribuesit aktiv është 3,979 euro. Mesatarisht, kontributpaguesit kanë më pak se 4,000 euro kursime pensionale, apo të hyra prej 200 euro për 20 muaj pas pensionimit. Pas 20 muajsh të gjithë do varen nga pensioni i pleqërisë që e ndanë qeveria.

Në raportet vjetore të Trustit, bëhet thirrje për rritjen e kontributeve pensionale. Nëse supozohet se çmimi i aksionit të Trustit çdo muaj do të rritet me një normë konstante prej 4% në vit, një person i cili punësohet në ditëlindjen e tij të 25-të dhe që kontribuon në minimumin ligjor për 40 vjet deri në pensionim, do të ketë një bilanc të akumuluar në llogarinë e tij në Trust prej €18,142. Megjithatë, duke qenë se inflacioni e gërryen vlerën e parasë, nëse inflacioni është p.sh. 2% në vit, vlera e sotme e atij bilanci do të ishte €8,216. Kjo vlerë, e kursyer përmes kontribuimit minimal, do të ishte e pamjaftueshme për të blerë një anuitet ekonomikisht të favorshëm të jetës. Në rrethanat aktuale një person i tillë do të pensionohej në programin e tërheqjes me faza, me mundësi të tërheqjes në një pagesë fillestare të 20% të totalit të bilancit, tërheqjen e shumës së mbetur nga €200 në muaj, që nuk mjaftojnë as për 4 vjet.<sup>111</sup>

<sup>109</sup> Qeveria e Kosovës. Vendimi nr.02/81 për aprovimin e Koncept dokumentit për rregullimin e fushës së pensioneve, mars 2016.  
<sup>110</sup> Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës. Raporti vjetor 2016. Burimi: <http://bit.ly/2AkgfzV>  
<sup>111</sup> Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës. Raporti vjetor 2016.

**DIALOGU  
SOCIAL**

## 7. Dialogu social

Me qëllim të zhvillimit të dialogut social në mes të të punësuarve dhe punëdhënësve, me Ligjin për Këshillin Ekonomiko-Social<sup>112</sup> është themeluar Këshilli në përbërje të 15 anëtarëve: pesë përfaqësues nga organizatat e të punësuarve, pesë përfaqësues nga organizatat e punëdhënësve dhe pesë përfaqësues nga Qeveria e Kosovës. Këshilli Ekonomiko-Social (KES) është organ i nivelit nacional, i cili udhëheq konsultimet dhe ju jep propozime organeve kompetente për çështjet nga marrëdhënia e punës, mirëqenia sociale dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me politikat ekonomike në Kosovë.

KES mbledhet një herë në muaj. Për pjesëmarrje në takimet e KES, anëtarët kompensohen me barasvlerën e 10% të rrogës së një ministri, kurse për pjesëmarrje në komisionet profesionale kompensimi është në barasvlerë të 10% të pagës së një sekretari të përgjithshëm të ministrisë. Sipas kësaj formule, kompensimi mujorë për anëtar të KES është 140 euro në muaj, kurse për pjesëmarrje në komisione është 105 euro në muaj. Nëse marrim për bazë agjendat e diskutimit<sup>113</sup> dhe rezultatet nga takimet e KES<sup>114</sup>, shihet se ministrat nuk marrin rregullisht pjesë në takime, tema të caktuara diskutohen vazhdimisht me vite pa ndonjë rezultat konkret, takimet mbahen edhe në rastet kur në rend të ditës ndodhen pika vetëm për vizita jashtë vendit, kurse rezultatet konkrete konsiderohen dizajnimi faqes së internetit, dizajnimi i logos, punimi i vulës së KES, pjesëmarrja në takime, etj.

Më 2011, KES vendosi pagën minimale dy shkallëshe: 130 euro për personat deri 35 vjet dhe 170 euro për personat mbi moshën 35. Kosova është i vetmi vend në Evropë i cili bën përshkallëzimin e pagës në bazë të moshës së të punësuarve, përderisa ka shtete të cilat aplikojnë shkallë të ndryshme minimale në bazë të sektorit të punësimit.<sup>115</sup> Nuk dihet se si është vendosur paga minimale, ngase më 2011 nuk ka pasur bazë ligjore për caktimin e pagës minimale. Më 2013 ka hyrë në fuqi Udhëzimi administrativ për kriteret dhe procedurën e caktimit të pagës minimale.<sup>116</sup> Sipas këtij Udhëzimi, paga minimale mund të rishikohet në dhjetor të çdo viti kalendarik, nëse plotësohen këto dy kushte: në rast se ka rritje të çmimeve vjetore të konsumit prej më shumë se 2% në vit dhe nëse Norma Reale Efektive e Këmbimit e cila publikohet nga BQK është më e vogël se 0.5%. Në periudhën 2012-2016 inflacioni i akumuluar është 4.5%. Nga 2011 nuk ka pasur ndryshim të pagës minimale në Kosovë. Në vitin 2013, partnerët social ishin pajtuar që paga minimale të jetë 220 euro, pa dallim në moshë, por kjo nuk ka marrë asnjëherë aprovimin e qeverisë.<sup>117</sup> Paga minimale në Kosovë është më e ulëta në krahasim me vendet e rajonit.

112 Gazeta Zyrtare. Ligji nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social. Burimi: <http://bit.ly/2jwzf5V>

113 BSPK. Aktivitetet e BSPK për vitin 2016. Burimi: <http://bit.ly/2ijCwcf>


114 KES. Raporti i punës së KES për periudhën maj 2013-maj 2014. Burimi: <http://bit.ly/2Bx7ltg>

115 Shembull për këtë është Qipro. Burimi: Raporti i IKS për pagën minimale, <http://bit.ly/2AhppiN>

116 Gazeta Zyrtare. Udhëzimi administrative nr.09/2013 për kriteret dhe procedurën e caktimit të pagës minimale në Republikën e Kosovës. Burimi: <http://bit.ly/2Aim5nl>

117 BSPK. Raport nga mbledhje e KES, dhjetor 2012. Burimi: <http://bit.ly/2nf2QpU>

Figura 32. Paga minimale në vendet e rajonit\*



\*24,000 Lek në Shqipëri, 22,000 Dinarë në Serbi, 12,000 denarë në Maqedoni

Në bazë të Ligjit të punës, me qëllim të avancimit dhe konkretizimit të drejtave të punëtorëve, organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve mund të nënshkruajnë marrëveshje kolektive.<sup>118</sup> Më 2014, partnerët social të përfaqësuar në KES nënshkruan Marrëveshjen kolektive e cila do të duhej të fillonte zbatimin nga 1 janari 2015. Por në fillim të vitit 2015, Marrëveshja u pezullua nga Ministri i MPMS, pas ankesave se Marrëveshja është në kundërshtim me Ligjin e punës ngase parasheh zbatim të saj edhe nga ata që nuk janë nënshkrues të marrëveshjes.

Puna e KES është kritikuar disa vite radhazi edhe në raportet për Kosovën të Komisionit Evropian. Sindikatat e punëtorëve janë të përçara, kurse organizatat e punëdhënësve përfaqësohen minimalisht.<sup>119</sup> Në vazhdimësi është kërkuar ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social. Sipas PKZMSA, parashihej që në fund të vitit 2016 të aprovohej ligji i ri për KES, si dhe të aprovohej Strategjia për Këshillin Ekonomiko-Social.<sup>120</sup> Ndryshimet ligjore parashihet që të vendosin kriteret më të qarta për anëtarësimin në KES. Po ashtu, ligji i ri për KES parashihet që të transponoj direktivat e BE, sidomos ato për krijimin e Komitetit për punësim (2000/98/KE) dhe direktivën për krijimin e Samitit social trepalësh (2003/174/KE).

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KES është përfshirë në programin legjislativ të Qeverisë për vitet 2015 dhe 2016, por ai nuk ka shkuar në Kuvend deri në fund të nëntorit 2017.

118 Gazeta Zyrtare. Ligji nr.03/L-212 i punës, neni 90. Burimi: <http://bit.ly/2jx6Pc3>

119 European Commission. Kosovo 2016 Report. Burimi: <http://bit.ly/2INRFCl>

120 Qeveria e Kosovës. Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA. Mars 2016. Burimi: <http://bit.ly/2Ae6GnX>

**PËRFUNDIM**

## 8. Përfundim

Të gjeturat e këtij raporti tregojnë se politikat e punësimit dhe mirëqenies sociale zënë vend të konsiderueshëm në dokumentet strategjike dhe programet e qeverive, por zbatueshmëria e tyre është ende në nivel të ulët. Disa nga shkaqet për nivelin e ulët të zbatueshmërisë së masave të ndërlidhura me punësimin dhe mirëqenien sociale kanë të bëjnë me jo stabilitetin institucional, ndërrimet e shpeshta në krye të institucioneve vendimmarrëse si pasojë e zgjedhjeve të parakohshme, mungesa e vullnetit politik, mos harmonizimi i aktiviteteve dhe objektivave me ndarjet buxhetore dhe presioni nga grupe të caktuara të shoqërisë.

Me Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asocim, Agjendën për Reforma Evropiane dhe Programet për Reforma në Ekonomi, Qeveria e Kosovës ka dhënë zotime për adresimin e sfidave të papunësisë dhe mirëqenies sociale, por në dy vitet e fundit prej kur ka filluar zbatimi i këtyre marrëveshjeve, institucionet kanë bërë shumë pak në drejtim të arritjes së këtyre objektivave.

Buxheti prej mbi 400 milionë euro në vit i cili ndahet për skema të ndryshme sociale, do të ishte i mjaftueshëm për të nxjerrë të gjithë qytetarët nga varfëria. Por vetëm një pjesë shumë e vogël e kësaj shume (8.3%) shkon për kategoritë më të varfra. Pjesa tjetër shkon për financimin e skemave mbi bazën e kategorive, ku jo domosdoshmërisht përfitojnë kategoritë më të varfra. Zbatimi i skemave sociale sipas kategorive, pa marrë për bazë statusin social, ka ndikuar në rritjen e transfereve sociale në dëm të kategorive më të varfra. Përderisa skemat në bazë të kategorive kanë shkuar duke u rritur, ato të varfërisë kanë mbetur thuajse të njëjta.

Pensionet e veteranëve të luftës së UÇK shpërfaqin më së miri dukurinë e ndikimit në politika nga grupe të interesit të ndërlidhura me partitë, ku institucionet shtetërore i nënshtrohen presionit të një kategorie të caktuar. Në fund të 2017, buxheti për veteranët e luftës ka kaluar mbi 1% të GDP. Mbi 35,000 persona marrin pension të veteranit, kurse për këtë status kanë aplikuar mbi 66 mijë persona. Verifikimi i listave të veteranëve, i iniciuar gati tetë vite më parë, nuk ka përfunduar ende. Liderët institucional pranojnë se listat janë të fryra dhe se një pjesë e madhe e përfituesve nuk kanë qenë pjesë e luftës. Por kjo nuk i ka ndaluar institucionet që të ndërpresin pensionet për veteranët.

Në anën tjetër, veteranët e luftës dhe disa deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë kundërshtuar me ngulm dhënien e pensioneve për viktimat e torturës dhe dhunës seksuale. Pas një rezistence të madhe institucionale, pensionet për këtë kategori do të fillojnë të ndahen nga viti 2018 dhe shuma e buxhetuar prej një milionë euro do të jetë e mjaftueshme për kompensimin e vetëm 350 viktimave. Komisioni për verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale pret që në fillim të vitit 2018 të aplikojnë deri në një mijë persona.

Ndihmat sociale prej 50 deri 150 euro në muaj, nuk janë të mjaftueshme për të nxjerr individët dhe familjet nga varfëria. Edhe pas marrjes së ndihmave sociale, mbi 70% e familjeve vazhdojnë të jetojnë në varfëri. Përveç kësaj, për shkak të kriterëve rigorozë, vetëm 35% e familjeve në varfëri arrijnë që të përfshihen në Skemën e Ndihmës Sociale. Varfëria është më e lartë në mesin e familjeve me gra kryefamiljare, familjet me shumë fëmijë, familjet nga komunitetet pakicë, familjet që nuk kanë asnjë të punësuar apo nuk marrin remitenca.

Politika sociale në Kosovë bazohet në transfere të parave, e shumë pak në investime sociale, qoftë në kapitalin njerëzor, qoftë në infrastrukturën e cila mbështet shërbimet sociale. Procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale nuk ka arritur që të avancoj shërbimet sociale, por përkundrazi janë shfaqur probleme më të mëdha për shkak të kufizimeve buxhetore të komunave. Planet e Qeverisë për të ndarë një grant social për komunat, ashtu sikurse granti për arsim dhe shëndetësi, nuk janë zbatuar ende.

Papunësia e lartë dhe gjendja e vështirë sociale ka ndikuar në largimin e një pjesë të popullsisë nga Kosova, kryesisht popullsi në moshë të punës. Nga janari 2014 deri në gjysmën e parë të vitit 2017, rreth 6% e popullsisë është larguar nga Kosova. Përkundër asaj se një pjesë e tyre janë riatdhesuar, gjendja e tyre sociale është më e rënduar se sa para largimit.

Kosova vazhdon të ketë shkallën më të lartë të papunësisë së të rinjve dhe grave. Një në pesë gra nuk është fare aktive në tregun e punës, përkundër asaj se viteve të fundit gratë diplomojnë më shumë në të gjitha nivelet e shkollimit.

### Bazuar në të gjeturat e këtij raport, rekomandojmë:

- ✓ Qeveria e Kosovës duhet të aprovojë Strategjinë për Punësim dhe Mirëqenie Sociale 2018-2022 dhe të alokojë buxhet të mjaftueshëm për aktivitetet dhe përmbushjen e objektivave të parapara me draftin aktual të strategjisë.
- ✓ Qeveria të aprovojë Udhërrëfyesin për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2021 si dhe të publikojë raportin për zbatueshmërinë e masave që ndërlidhen me punësimin dhe mirëqenien sociale për vitet 2016-2017.
- ✓ Programi legjislativ për vitin 2018 të përfshijë të gjitha aktet ligjore të parapara me Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA, veçanërisht Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të punës; Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social; Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga buxheti i shtetit, si dhe të aprovohen aktet nënligjore nga fusha e sigurisë në punë të parapara me PKZMSA.
- ✓ MPMS, të aprovojë Planin e Veprimit për adresimin e papunësisë së të rinjve, ashtu siç parashihet me Agjendën për Reforma Evropiane.
- ✓ MPMS të hartojë Planin e Veprimit për eliminimin e barrierave për pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, i cili parasheh eliminimin e barrierave të ndryshme.
- ✓ Funkcionalizimi i plotë i Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës (APRK), duke emëruar Bordin Këshillëdhënës, duke hartuar aktet e mbetura nënligjore të parapara me Ligjin për APRK, rritjen e stafit në zyrat e punësimit dhe qendrat e aftësimin profesional dhe rritjen e buxhetit për masat aktive në tregun e punës.
- ✓ APRK të hartojë një dokument zyrtar për Nevojat e Tregut të Punës, i cili merr parasysh të gjeturat e bizneseve dhe organizatave kërkimore dhe në bazë të tij të përshtat kurset e trajnimeve që ofrohen nga QAP. Për kurset të cilat nuk janë të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, APRK të licencoj dhe financoj ofrues privat të trajnimeve. APRK dhe MASHT të bëjnë ndërlidhjen e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Punësimit (SIMP) me Sistemin e Menaxhimit të Informatave Arsimore (SMIA).



- ✓ Të ngritët numri i inspektorëve të punës dhe kapacitetet logjistike, me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit të punës dhe ligjeve tjera që rregullojnë sigurinë dhe shëndetin në punë. Gjithashtu, Agjencia e Inspektoratit të Punës të funksionalizoj Sistemën për Menaxhimin e Informatave i cili do të lehtësonte dhe përshpejtonte procedurat e inspektimit, duke verifikuar të dhënat automatikisht me ATK dhe Trust.
- ✓ Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë në të cilën përfshihet edhe granti specifik për shërbimet sociale, i cili i ndahet komunave varësisht nga familjet dhe individët që marrin shërbimet sociale nga Qendrat për Punë Sociale.
- ✓ MPMS të ndajë një grant specifik për mbështetjen e organizatave jo qeveritare të licencuara të cilët kryejnë shërbime të ndryshme sociale.
- ✓ Qeveria të përfundojë sa më parë procesin e verifikimit të listave të veteranëve dhe të kufizoj në 0.7% të GDP shumën vjetore për pensionet e veteranëve, ashtu siç parashihet në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veteranët e UÇK.
- ✓ MPMS të hartojë një koncept dokumenti i cili parasheh gradualisht shkrirjen e skemave sociale bazuar në kategori, në një skemë të vetme sociale, e cila kriter bazë do të ketë gjendjen sociale. Skema e re sociale duhet që së paku të mbulojë kufirin e varfërisë, duke rritur kompensimet për familjet me më shumë anëtarë. Njëkohësisht, skema e re sociale do të transferoj pensionet bazike në pensione sociale të cilat nuk do të bazohen në moshë, por në gjendjen sociale të personave të moshuar.

